



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor  
“Administrim Biznesi ”  
“Universiteti Ismail Qemali” Vlorë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Etleva Leskaj

Dr. Alba Kruja

Prill/2020



# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV), është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 105, datë 28.02.1994 me emërtim "Universiteti i Vlorës" dhe riorganizuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 822, datë 05.12.2007 dhe riemërtuar "Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë".

Universiteti zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

UV është i organizuar në katër fakultete:

- (1) Fakulteti i Ekonomisë;
- (2) Fakulteti i Shëndetit Publik;
- (3) Fakulteti i Shkencave Humane;
- (4) Fakulteti i Shkencave Teknike.

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" licensuar me VKM Nr. 105, datë 28.02.1994 me afat studimi 4 vite dhe riorganizuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit, shkresë Nr. 121 Prot. Datë 22.07.2009 nga program Bachelor me kohëzgjatje 4 vite në 3 vite. Ky program ofrohet nga Departamenti i Biznesit, pranë Fakultetit të Ekonomisë (FE).

FE është i organizuar në tre departamente:

- (1) Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
- (2) Departamenti i Biznesit;
- (3) Departamenti i Ekonomiksit.

Departamenti i Biznesit ofron studime në shtatë programe, tre të ciklit të parë bachelor dhe katër të ciklit të dytë si më poshtë:

- (1) Bachelor në Administrim Biznesi
- (2) Bachelor në Manaxhim Turizmi
- (3) Bachelor në Marketing
- (4) Master Profesional në Administrim Publik
- (5) Master Profesional Siper marrje në Turizem
- (6) Master Profesional në Marketing
- (7) Master Shkencor në Administrim Biznesi

Misioni i Departamentit të Biznesit është përgatitja, formimi dhe diplomimi i studentëve të aftë në fushën e biznesit, turizmit dhe marketingut në përputhje me trendet e tregut të punës në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin rajonal e kombëtar, por edhe në atë evropian e më gjerë (Rregullorja e Departamentit të Biznesit, fq.4).

Hapja e programit Bachelor në Administrim Biznesi daton me fillimin e aktivitetit të UV, si një ndër katër programet e para të këtij Institucioni të Arsimit të Lartë.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit **Bachelor** në “Administrim Biznesi” të ofruar nga Departamenti i Biznesit pranë UV, filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në UV u realizua gjatë datave 5-6/03/2020, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Në ditën e parë të vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u takua me: Përgjegjësin e Departamentit dhe Dekanin e FE, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, sekretarinë mësimore dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë ditës së dytë të vizitës u zhvilluan takime me Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Edukimit për Ciklin e I& II, intervista me studentët si dhe u vizitë në Bibliotekën e Institucionit.

Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, GVJ filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorin Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

**Shënim:** Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me IAL Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 date 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

Më datë 07.04.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 34/33 Prot., datë 07.04.2020 “*Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm*”, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UV përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft–Raportin, me shkresë Nr. 569/3 Prot., datë 14.04.2020 “*Përcjellje e komenteve mbi draft Raportin e vlerësimit të jashtëm*”. Në këtë dokument institucioni ka disa komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet e UV sqaron si më poshtë:

### **1. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi I.3 Kriteri 1, 3**

“Në Rregulloren e Departamentit të Biznesit janë të përcaktuara në Nenin 2 Misioni dhe Objektivat e Departamentit në përgjithësi, por jo specifike për çdo program studimi. Ndërkohë në Suplementin e Diplomës qartësohen disi objektivat e formimit të studentëve si më poshtë:

*“Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi synon të përgatisë ekonomistë të profilit me njohuri baze dhe të thelluara bashkëkohore për t’u adaptuar për llojet e ndryshme të biznesit, të aftë për të punuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, në përputhje me nevojat e tregut të punës. Të diplomuarit në Administrim Biznesi do të jenë në gjendje të përdorin dhe vlerësojnë mjetet për analizimin e*

*kompanisë, të njohin kërcënëmet dhe mundësitë me të cilat përballen organizata në mjedise vazhdimisht të ndryshueshëm dhe global dhe të jenë në gjendje për marrjen e vendimeve optimale në nivele të ndryshme të administrimit të bizneseve.”GVJ sugjeron përcaktimin e objektivave të formimit dhe profilizimit të studentëve në Rregulloren e Departamentit të Biznesit jo vetëm të programit Bachelor në “Administrim Biznesi”, por edhe të dy programeve të tjera të ofruara nga Departamenti.” (Evidenca 2.5-Rregullore e Departamentit të Biznesit, Neni 2, fq.4-5); (Evidenca 1.5-Suplement Diplome, fq. 2)*

## **2. Paragrafi në draft RVJ**

### **Standardi II.1 kriteri 5**

Objektivat formues dhe kompetencat profesionale janë të përcaktuara në Suplementin e Diplomës, por jo në planet mësimore apo rregulloren e programit.

#### ***Komenti i IAL***

*“Objektivat e programit të studimit si dhe strategjite afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata janë të përcaktuara në mënyrë specifike në Strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi (Evidenca 2.14).*

#### **Argumentimi i GVJ (per te dy komentet)**

Në RVB si evidence lidhur me përcaktimin e qarte të objektivave të studimit të programit është raportuar Evidences C “Rregullore e UV” dhe jo Evidences 2.14 për “Plani Strategjik për Programin e Studimit Bachelor në Administrim Biznesi 2020-2024”. Si në rregulloren e UV ashtu dhe në rregulloren e departamentit, nuk janë pasqyruar objektivat e formimit dhe të profilizimit të studentëve për programet e ofruara nga departamenti i Administrim Biznesit.

Komenti i institucionit **pranohet**, pasi kjo mungese e përcaktimit të objektivave specifike të çdo programi studimi në Rregulloren e Departamentit, është reflektuar gjatë hartimit të Planit Strategjik për vitet 2020-2024.

## **3. Paragrafi në draft RVJ**

### **Standardi I.3 kriteri 2**

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se studimet mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin Bachelor në “Administrim Biznesi”, nuk janë kryer përpara hapjes së programit dhe nuk kryen në mënyrë periodike, por në funksion të thirrjeve për projekte. Ekziston vetëm një studim në kuadër të projektit “Fondi i Ekselencës” në vitin 2011-2012, me titull “Impakti në punësimin i kurrikulave të nivelit të parë të studimeve pranë FE të UV”.

#### ***Komenti i Institucionit***

*“Studimet e tregut të punës nuk kanë qenë periodike por janë bërë disa studime të iniciuara në kuadër të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, ku pedagogët e Departamentit të Biznesit janë angazhuar si eksperte të jashtëm në projektin TRANS-EDU-NET (2017-2018), rezultatet e të cilave kanë shërbyer dhe në ndryshimet në planet mësimore që ofron Departamenti. Studime të tregut të konkretizuara në punim diplome në nivel master shkencor në vitin 2019. Studime tregu të bera nga Drejtoria e Edukimit të UV-se mbi gjurmimin e studentëve të punësuar në profesion.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Studim në kuadër të projektit “Fondi i Ekselencës” në vitin 2011-2012, me titull “Impakti në punësim i kurrikulave të nivelit të parë të studimeve pranë FE të UV”, është i vetmi studim i institucionit i cili ka në fokus të drejtperdrejte impaktin e kurrikulave të FE, UV në punësimin e studenteve.

Megjithatë në komentin e institucionit theksohet se rezultatet e projektit TRANS-EDU-NET (2017-2018) kanë shërbyer në ndryshimet në planet mesimore që ofron Departamenti, GVJ-se nuk iu janë raportuar evidenca lidhur me këto fakt.

Studimi i tregut i konkretizuara në punim diplome në nivel master shkencor në vitin 2019, nuk është i lidhur me të diplomuarit e UV dhe të FE, por me të diplomuar nga Universitete të ndryshme private dhe publike në Shqipëri. Komenti i institucionit **pranohet pjesërisht**.

#### 4. Paragrafi në draft RVJ

##### **Standardi I.5 kriteri 2**

GVJ vlerëson bashkëpunimet e raportuara në RVB me institucione të shumta homologe jashtë vendit të cilat kanë kontribuar në shkëmbimin e eksperiencave, kualifikimin e stafit mësimdhënës, dhe zhvillimin e punëve kërkimore të përbashkëta. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se këto marrëveshje bashkëpunimi nuk kanë rezultuar po aq të dobishme për studentët, pasi asnjë student i programit Bachelor në “Administrim Biznesi” nuk ka shfrytëzuar mundësitë e mobilitetit.

*Gjatë vizitës në institucion u konstatua se këto marrëveshje bashkëpunimi nuk kanë rezultuar po aq të dobishme për studentët, pasi asnjë student i programit Bachelor në “Administrim Biznesi” nuk ka shfrytëzuar mundësitë e mobilitetit.*

##### ***Komentet e zyrave të Institucionit***

*Studentet për arsye personale kanë anuluar marrëveshjen, apo për mos përmbushje të kriterit të gjuhës.*

***Në përmbushje të kriterit, DSBCP komenton:*** DSBCP harton në mënyrë periodike raporte analitike të përfitimëve nga marrëveshjet e bashkëpunimit jo vetëm në kontekstin e shkëmbimeve të stafit/studentëve të realizuar gjatë periudhës së raportimit por gjithashtu analizon efektivitetin e këtyre bashkëpunimeve, arritjet/pengesat si dhe sugjeron mekanizmat të cilat do të çonin në realizimin e suksesshëm të bashkëpunimeve me partnerët ndërkombëtar.

***Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP komenton:*** Thirrjet për aplikim që u adresoheshin dhe studentëve të këtij programi studimi nuk kanë qenë të pakta. Megjithatë DSBCP së bashku me Studentët Erasmus si dhe departamentin në mënyrë periodike kanë organizuar fushata informuese/sensibilizuese mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, ku studentet ftoheshin të aplikonin dhe të bëheshin pjesë e familjes së madhe Erasmus+, por pengesa të ndryshme si ato familjare, mos zotërimi i nivelit të duhur të gjuhës angleze, apo ndonjëherë dhe hezitimi i studentëve për të ndërmarrë një eksperiencë të re kanë sjellë rezultatet e komentuar prej GVJ.

*Vlen të theksohet fakti se në këtë program studimi kemi aktualisht duke frekuentuar semestrin e dytë pranverë 2020 dy studentë hyrës, prej Aurel Vlaicu University of Arad, Rumania.*

*Shpresojmë që eksperiencia e studentëve hyrës në UV të rris interesimin e studentëve tanë për të aplikuar dhe qenë përfitues direkt të këtyre marrëveshjeve.*

##### **Argumentimi i GVJ**

Komenti i institucionit **pranohet pjesërisht**.

## 5. Paragrafi në draft RVJ

### Standardi I.5 kriteri 2

Referuar dokumentave të dorëzuara si dhe RVB, nuk rezultojnë evidenca të bashkëpunimeve me institucione homologe brenda vendit.

#### *Komenti i Institucionit*

*UV liston me detaje llojet e bashkëpunimit, jo te raportuara ne RVB.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Komenti i institucionit **pranohet**.

## 6. Paragrafi në draft RVJ

### Standardi I.5 kriteri 3

GVJ konstaton se bashkëpunimi me aktorët e biznesit vendas i programit në fjalë është vetëm në kuadër të praktikave profesionale. GVJ rekomandon që programi i studimit të shtojë larmishmërinë dhe numrin bizneseve, (pasi një pjesë rezulton të jenë furrë buke, market e kafene) si inkorporimin e një bashkëpunimi sinergjik në kuadër të ko-krijimit të vlerave për të gjithë aktorët në fjalë. Nga dokumentacioni i dorëzuar nuk rezulton që programi të ketë bashkëpunim me aktorë të biznesit të huaj.

#### *Komenti i Institucionit*

*UV liston lloje bashkëpunimesh te cilat nuk jane relevante apo nuk jane raportuar evidenca, pervec Workshopit “Studentet dhe tregu i punes”, i cili eshte organizuar ne rang institucional dhe jo ne rang departamenti.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Komenti i institucionit **nuk pranohet**.

## 7. Paragrafi në draft RVJ

### Standardi II.2 kriteri 1

UV është akredituar institucionalisht, sipas VBA-ASCAL, nr 246 të datës, 28.09.2017.

#### *Komenti i Institucionit*

*DSBCP saktëson: UV është akredituar institucionalisht, me Vendim të BA-ASCAL, Nr. 71, datë 21.09.2017.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Komenti i institucionit pranohet

## 8. Paragrafi në draft RVJ

### Standardi II.3 kriteri 7

GVJ rekomdandon që Departamenti i Biznesit, përkrah ndryshimeve të bëra në programin mësimor të

dokumentoje edhe një përmbledhje të analizës së tregut apo diskutimeve në departament apo detyrimeve ligjore e nënligjore nxitëse të këtyre ndryshimeve.

#### ***Komenti i Institucionit***

*UV i referohet procesverbalit të firmosur nga anetaret e departamentit (dokument i kërkuar gjatë vizites në institucion, por i dorëzuar pas draft raportit) për ndryshimin e kurrikulës, por në të cilin nuk është reflektuar analiza e tregut si dhe diskutimet në departament lidhur me ndryshimet në ECTS të shumë lendeve.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Ky procesverbal lidhur me ndryshimet e kurrikulës, është dokument i kërkuar gjatë vizites në institucion, por i dorëzuar pas draft raportit. Gjithsesi në këtë procesverbal nuk është reflektuar analiza e tregut si dhe diskutimet në departament lidhur me ndryshimet në ECTS të shumë lendeve.

Komenti i institucionit **pranohet pjesërisht**.

### **9. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi II.4 kriteri 4**

GVJ sugjeron që Departamenti i Biznesit të përafrojë programin e studimit me programe të ngjashme ndërkombëtare, për të mundësuar punësimin dhe mobilitetin e studentëve në vendet e Bashkimit Europian.

#### ***Komenti i Institucionit***

*UV në koment nuk sjell evidenca të reja.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Komenti **nuk pranohet**.

### **10. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi III.1 kriteri 5**

GVJ konstaton se në Raportin Vjetor të Departamentit të Biznesit për vitin akademik 2018-2019, lidhur me analizën e cilësisë në mësimdhënie janë raportuar vetëm statistika të mesatareve të studentëve për çdo lëndë si dhe përqindjes së kalueshmërisë së tyre.

Për sa më sipër, GVJ rekomandon që përtej analizave sasiore, departamenti të fokusohet edhe në analiza cilësore si dhe shkëmbimin e eksperiencave midis stafit apo hulumtimit me fokus përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie. (Evidenca 1.9 Raporti Vjetor i Departamentit të Biznesit, 2018-2019)

#### ***Komenti i Institucionit***

*UV në koment bën një detajim të informacionit të përfshirë në raportin vjetor.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Në raport janë përfshirë informacione të tjera, por që nuk përbejnë analiza të mëtejshme cilësore lidhur me mesimdhënien. Komenti i institucionit **nuk pranohet**.

## 11. Paragrafi në draft RVJ

### Standardi III.2 kriteri 1,2,3

Në planin mësimor të programit praktika është paraqitur si orë studimi individuale, fq. 85 e RVB. GVJ e konsideron praktikë në auditor **për studentin** (pavarësisht se për stafin ajo konsiderohet si punë në terren).

#### *Komenti i Institucionit*

*UV argumenton se praktika profesionale duhet konsideruar si ore jashte auditorit.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Komenti i institucionit **pranohet**.

## 12. Paragrafi në draft RVJ

### Standardi III.3 kriteri 5

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi hapësirat e bibliotekës së institucionit janë të vogla dhe të pamjaftueshme duke konsideruar numrin e studentëve që studiojnë në institucion. Gjithashtu biblioteka ka një numër tepër të kufizuar të botimeve lidhur me fushën e studimit të programit jo vetëm në literaturën e huaj por edhe atë shqipe.

#### *Komenti i Institucionit*

*UV komenton se biblioteka i shërben vetem fakultetit te FE, si dhe gjate viteve te fundit fondi i bibliotekes eshte permiresuar.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Komenti i UV nuk sjell fakte apo evidenca te reja dhe komenti **nuk pranohet**.

## 13. Paragrafi në draft RVJ

### Standardi III.3 kriteri 6

GVB raporton rreth funksionimit të bibliotekës online nëpërmjet Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), ndërkohë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kjo marrëveshje është ndërprerë në dhjetor të vitit 2019. GVJ rekomandon rinovimin e kësaj marrëveshjeje, apo marrëveshjeve me bibliotekë online të tjera si J-Store etj.

#### *Komenti i Institucionit*

*Institucioni sjell evidenca per funksionimin e bibliotekes on-line, si dhe kerkeses per regjistrim ne J-store.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Komenti i institucionit **pranohet**.

## 14. Paragrafi në draft RVJ

### Standardi III.6 kriteri 4

GVJ konstaton se testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, nuk zhvillohet në mënyrë anonime



me sekretim ose kodifikim.

#### ***Komenti i Institucionit***

*UV argumenton se sekretimi i provimeve nuk eshte pjese e rregullores institucionale.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Argumenti i UV nuk ndryshon faktin e mospermbushjes se kriterit. Komenti i institucionit **nuk pranohet**.

#### **15. Paragrafi në draft RVJ**

##### **Standardi III.6 kriteri 6**

GVJ rekomandon që institucioni të investojë në sigurimin e një programi antiplagjaturë.

#### ***Komenti i Institucionit***

*UV komenton se procesi i investimit ne programin antiplagjaturë ka filluar, por nuk raporton evidenca.*

#### **Argumentimi i GVJ**

Komenti i institucionit **nuk pranohet**.

#### **16. Paragrafi në draft RVJ**

##### **Standardi IV.2 kriteri 1**

“Pavarësisht për sa më sipër, referuar evidencës për kapacitetet infrastrukturore si dhe RVB tabela 2.16, rezulton vetëm një zyrë për stafin akademik të departamentit”. (*Evidenca 69 Infrastruktura.PDF*)

#### ***Komenti i Institucionit***

*UV në komentet e sjella, argumenton se: “Referuar aneksit1, tabela 16, njësia kryesore ka 10 zyra, ndër të cilat 5 zyra janë në dispozicion të njësisë bazë”*

#### **Argumentimi i GVJ**

GVJ në draft RVJ i është referuar deklaramit ne RVB të një zyre, në tabelën 2.16. Mbas paraqitjes nga institucioni të komenteve dhe referuar tabelës 16 Aneksi 1, rezultojnë 5 zyra në dispozicion të njësisë bazë përgjegjëse për PS, AB. Komenti i institucionit **pranohet**.

#### **17. Paragrafi në draft RVJ**

##### **Standardi IV.2 kriteri 2**

GVJ sugjeron një qasje më proaktive nga ana e institucionit, në formatin e një politike motivuese e sanksionuar për gjithë stafin akademik, e planifikuar në buxhetin vjetor e cila do të nxiste një përfshirje më të gjerë të stafit akademik të programit në aktivitete shkencore dhe që do të shërbente, edhe si bazë për vlerësimin e performancës së stafit.

Gjithashtu në kudër të programit Erasmus +, UV ka marrëveshjeve të përbshkëta me universitete të huaja, të cilat krijojnë mundësi për stafin akademik të krijojnë eksperiencë mësime dhe në këto universitete dhe të mund të përfitojnë profesionalisht prej këtyre eksperiencave, por këto deri tani rezultojnë si potenciale për të ardhmen. Duke iu referuar të dhënave të siguruara, rezultojnë që gjatë 2018-2019 të ketë përfituar një pedagog i fakultetit të Ekonomisë.

### **Komenti i Institucionit**

Institucioni në objeksionet e tij, paraqet se stafit i është komunikuar përfitimi i shpenzimeve të udhëtimeve jashtë shtetit, nëpërmjet Urdhërit të administratores (Evidenca 2) dhe është e parashikuar në vendimin 76 të senatit, viti 2017.

Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP argumenton: Numri i lartë i marrëveshjeve KA107 garanton mundësinë e realizimit të shkëmbimeve të stafit/ studentëve midis universiteteve partnere. Implementimi i tyre realizohet në varësi të fondeve që Universiteti i Vëndit të Programin përfiton si dhe shpërndarjes që ky i fundit i bën fondit përgjatë gjithë periudhën së vlefshmërisë së marrëveshjes. Nëse për vitin akademik 2018-2019 janë hapur 5 (pesë) thirrje për aplikim për personelin e Fakultetit të Ekonomisë ku në përfundim kanë përfituar 1 personel akademik, për vitin 2019-2020 nëse Europa nuk do të ishte përballur me situatën e shkaktuar nga COVID-19, do të ishin realizuar 7 mobilitetet prej stafit të UV-së si dhe po Fakulteti i Ekonomisë do të mirëpriste 10 staf akademik nga universitete të huaja. Gjithashtu, kanë përfituar prej marrëveshjeve edhe 4 staf akademik të angazhuar në programin e studimit.

### **Argumentimi i GVJ**

Institucioni në komentet e tij i referohet Evidencës 2 (Urdhëri i administratores për rimbursimin e shpenzimeve për udhëtime jashtë shteti), të cilën realisht GVJ nuk mundi ta konsultojë, sepse pavarësisht referimit në koment, kjo evidencë mungon. GVJ konsultoi në webin e institucionit vendimin 76 të senatit, të vitit 2017, nëpërmjet të cilit parashikohet financimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit jashtë shtetit të stafëve. Gjithsesi GVJ në sugjerimin e dhënë ka pasur parasysh një politikë motivuese proaktive, shpenzimet për zbatimin e secilës parashikohen në buxhet dhe që synojnë rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe mund të shërbejnë edhe bazë për vlerësimin e performancës së stafit.

GVJ vlerëson numrin e lartë të marrëveshjeve që UV ka, por shprehet për efektin e këtyre marrëveshjeve për stafin akademik në nivel njësie kryesore deri në nivel programor, që sic përshkruhet nga komenti I institucionit deri tani ka përfituar 1 pedagog

Për sa më sipër, GVJ **nuk pranon** komentet e institucionit

### **18. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi IV.4 kriteri 1**

Referuar evidencave për infrastrukturën e UV, sipërfaqja e saj është 250 m<sup>2</sup> me 60 poste dhe 9 Pc. GVJ rekomandon zgjerim të hapësirës së bibliotekës dhe përmirësim të kushteve të saj infrastrukturale, numer fizik postesh, vendosje të me shumë PC, për të qenë një mjedis më funksional dhe për të siguruar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e PS bch në Administrim Biznesi, duke qenë se kjo bibliotekë është biblioteka qendrore e institucionit dhe është në shërbim të studentëve dhe stafit akademik të shumë programeve studimi bachelor dhe master, edhe të njëjësive të tjera kryesore

### **Komenti i Institucionit**

Sektori i Bibliotekes Shkencore Komenton: Duhet theksuar se 6 (gjashtë) vitet e fundit shërbimi i bibliotekës ka qenë dhe është në një evolucion, duke u përmirësuar ndjeshëm në shërbimin e duhur ndaj studentëve. Përsa i përket kapacitetit akomodues, duhet të përmendim se hap përpara në këtë drejtim është ndarja e Bibliotekës së FSHT nga Biblioteka Qendrore, duke e lënë këtë të fundit në dispozicion vetëm të studentëve dhe pedagogëve të FE gjatë orarit mësimor dhe duke bërë që vetëm orët e pasdites (16.00-20.00) të jetë e vetmja bibliotekë për gjithë universitetin. Koeficienti i shfrytëzueshmërisë, llogaritur me numrin e përdoruesve të bibliotekës mbi numrin e vendeve në çdo sallë është afërsisht 0.67 ose 67 % shfrytëzohet. Në këtë bibliotekë është krijuar sipas standardeve dhe në mjedisin e duhur Arkivi i Bibliotekës.

### **Argumentimi i GVJ**

Krijimi i bibliotekës për FSHT do t'i japë efektet pozitive në vijim, deri tani situata është sikundër GVJ ka paraqitur. Nga ana tjetër koeficienti I shfrytëzimit, mendojmë se nuk është parametër esencial, përse kohë GVJ konstatoi se studentët nuk e shfrytëzojnë bibliotekën.

Komenti i institucionit **nuk pranohet**

### **19. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi IV.4 kriteri 2**

GVJ rekomandon se UV duhet të zgjerojë fondin e bibliotekës me një gamë më të gjerë librash në gjuhën shqipe dhe angleze, revistash shkencore, periodikë, si dhe me shumë literaturë bashkëkohore për programin e studimit PS në Bsc në “Administrim Biznesi”, duke qenë se edhe literatura bazë, duhet të jetë e 5 viteve të fundit, por edhe ajo ndihmëse duhet të jetë një literaturë e pasur bashkëkohore. Evidenca 4.3.PDF

#### **Komenti i Institucionit**

*Në objeksionet e paraqitura Institucioni argumenton se biblioteka është pasuruar vazhdimisht në 3 vitet e fundit, duke iu referuar evidencës 4.3 si dhe evidencës Evidenca 3 Fondi i bibliotekes 2017-2019.PDF, të sjellë në fazën e përcjelljes së komenteve.*

*Sektori i Bibliotekes Shkencore komenton: Vitet e fundit të gjitha blerjet janë orientuar kryesisht në literatura të botuara vitet e fundit, sipas kriterëve specifikë dhe kushteve teknike që ka blerja e librit, me autor, titull, ISBN, vit botimi, shtëpi botuese, sasi, çmim, mbështetur në kërkesat e përvitshme që na vijnë nga depart./ Fak. Mendojmë se ky kriter është respektuar, duke patur parasysh edhe faktin që në literaturën shkencore (studimore dhe ndihmëse) ekzistojnë edhe tekste bazikë, vlera shkencore e të cilave nuk mund të matet duke patur parasysh vitin e botimit.*

*Nga viti 2016-2019 janë bërë 2 (dy) blerje, të cilat kanë pasuruar burimet manuale të bibliotekës dhe e kanë freskuar ndjeshëm atë nëpërmjet përditësimit të literaturës, në shërbim të mbështetjes efektive të mësimin dhe hulumtimit të studentëve.*

*- Për vitin akademik 2016-2017, (në dhjetor 2017) Fakulteti i Ekonomisë: 107 tituj, nga këto 32 anglisht, 75 shqip me 1032 vëllime në gjuhën shqipe dhe 48 vëllime në gjuhën angleze, totali 1.080 vëllime; [shiko tabelën: Blerja 1 (V.A. 2016-2017) Loti 3, Libra për Ekonomi, Financë, Biznes] si dhe [shiko tabelën: Blerja 1 (V.A. 2016-2017) Loti 4. Libri në gjuhë të huaj].*

*-Për vitin akademik 2017- 2018: 35 tituj, nga këto 11 anglisht në 20 vëllime, 24 shqip në 333 vëllime, totali 353 vëllime; [shiko tabelën: Blerja 2 (V.A. 2017-2018). FE. Loti 3 “Libra per ekonomi, finance, biznes,” për Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë] si dhe [shiko tabelën: Blerja 2 (V.A. 2017 - 2018). FE. Loti 4-në Gj. Huaj].*

Gjithashtu, sipas studentëve që kemi pyetur, ka pedagogë që lëndët përkatëse i japin me leksione, prandaj ndoshta nuk kanë porositur tekstse. Ndërkohë, edhe pse Grupi i akreditimit GVJ thotë se në bibliotekë s'ka tekste të botuara pas vitit 2015, pa u futur në detaje, mund të sjellim në kujtesë vetëm tekstin “*Ekonomiksi i Zhvillimit= Economic Development*”, (bot. i vitit 2018). Pra ky tekst universitar me 955 f. (me autorë profesorët amerikanë: Michael P. Todaro [Univ. Nju-Jorkut], Stephen C. Smith [Univ. i Xhorxh Uashingtonit] dhe profesorët shqiptarë Luljeta Minxhozi, Arben Malaj [UET, Univ. Tiranës] apo të Univ. Europës JL, Tetovë, [Abdylmenaf Bexheti]) nuk quhet.

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ kur ka prezantuar këtë sugjerim në draftRVJ, ka shqyrtuar pikërisht Evidencën 4.3, ndërkohë Evidenca e re e përcjellë, prezanton një urdhër shpenzimi për bibliotekën, që demonstroi për blerje librash në tërësi për bibliotekën, por që nuk e kundërshtoi thelbin e sugjerimit të dhënë nga RVJ

Përsa më sipër, GVJ i mbetet sugjerimit të dhënë në draft RVJ.

Pavarësisht pasurimit të bibliotekës dhënë nga komenti i Institucionit, GVJ nuk gjen fakte thelbësore për ndryshimin e qëndrimit, që mbështet edhe në konstatimet në vizitën në institucion. Ne vazhdim argumenti i institucionet se ka pedagogë që lëndët përkatëse i japin me leksione, prandaj ndoshta nuk kanë porositur tekstse, nuk mund të pranohet.

Komenti i institucionit nuk pranohet

### **20. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi IV.4 kriteri 4**

Biblioteka disponon 9 PC dhe disa pajisje të tjera si skaner, fotokopje të cilat sugjerohen që të jenë në shfrytëzim pa kufizime nga studentët. Studentët mund të aksesojnë edhe librarianë elektronike nëpërmjet sistemit të Ulibrary.

#### **Komenti i Institucionit**

**Sektori i Bibliotekës Shkencore komenton:** Në dispozicion të studentëve të FE janë edhe 6 (gjashtë) kompjutera të “*Inkubatori i Biznesit*”, pra 9+6=15 PC, të cilët, së pari janë për studentët e Departamentit të Biznesit e më tej për studentët e tjerë të FE.

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ nuk gjen argumenta thelbësor shtesë për këtë koment. Kompjuterat e inkubatorit të biznesit apo laboratorëve të tjerë nuk janë në vlerësimin e këtij kriteri

Komenti i institucionit nuk pranohet

### **21. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi IV.4 kriteri 5**

GVJ nuk siguroi të dhëna për një plan të detajuar për vitin aktual 2019-2020, me të tituj të propozuar nga njësi bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për PS BA në Administrim Biznesi, mbi buxhetin e parashikuar për blerjen e librave, apo për vendimet e marra nga bordi i administrimit për financimin e tyre.

GVJ rekomandon rritjen e rolit të njësisë kryesore dhe asaj bazë, për shtimin e fondit të bibliotekës dhe

për pasurimin cilësor të saj më literaturë bashkëkohore për fushën ekonomisë në përgjithësi e për PS Bsc. AB në veçanti, duke startuar me propozime të stafit akademik, propozim të njësisë bazë e më pas propozime buxhetore për fonde në nivel njësie kryesore për bibliotekën, për tu financuar nga institucioni.

### ***Komenti i Institucionit***

*“Referuar titujve të librave të përcjella nga departamenti Biznesit, gjeni bashkëlidhur Evidencën 4, “Përcjellje e kërkesave buxhetore 19-21”*

*Sektori i Bibliotekës Shkencore komenton: Periudha në të cilën bëhen kërkesat dhe ekzekutohen blerjet e librave nuk përputhet me kohën në të cilën u bë vlerësimi. Kjo është arsyeja që në muajin mars nuk mund as të përpunohen kërkesa dhe as të ekzekutohen blerje për llogari të vitit përkatës.*

*Në shërbim të studentëve janë fondet e koleksioneve të bibliotekës me literaturë bashkëkohore, (manual dhe online), me libra të arkivit, me Buletinet Shkencore të Universitetit, [shiko tabelën: Listimi i botimeve me logon e UV. Listimi i librave/ teksteve: monografi, buletine me logon e universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë], si dhe buletine të universitetve të tjera, me të cilët kemi huazim literature, me botimet periodike të KLSH, [shiko tabelën: Libra të dhuruara nga KLSH (2017)] dhuruar Bibliotekës pikërisht për studentët e Fak. Ekonomisë, me revista të ndryshme në shqip, si “Monitor” etj. apo në gjuhë të huaja (prurje, të cilat synojmë t’i shtojmë/pasurojmë në tituj, me disertacionet e pedagogëve (doktoraturat/ sipas kritereve), temat e diplomave apo mikrotezat e studentëve, të cilat i kemi dhe të kataloguara, pikërisht për t’ua dhënë studentëve, në ndihmë të tyre, në shërbim të tyre, në mbështetje të procesit të mësimnxënies.*

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ gjatë fazës së shqyrtimit të dokumentacionit dhe fazës së terrenit, nuk hasi në një dokument të tillë, por duke shqyrtuar Evidencën 4, shtesë në fazën e përcjelljes së komenteve, konstaton se Departamenti i Biznesit, ka përcjellë kërkesat buxhetore mes të cilave, zë më vete konstatohet, pasurimi i Bibliotekës dhe titujt e sugjeruar. Ky koment i mësipërm është koment i dubluar nga komentet që departamenti ka sjellë për të cilën GVJ është shprehur më sipër

Për sa më sipër, me evidencën shtesë të përcjellë, komenti i institucionit **pranohet**

## **22. Paragrafi në draft RVJ**

### **Standardi IV.6 kriteri 1 dhe 2**

GVJ sugjeron që institucioni të bëjë analizë të kostove në nivel program studimi sic kriteri 1 e kërkon

GVJ nuk konstatoi plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e PS BA AB për një cikël të plotë studimi. (Kriteri 1). GVJ rekomandon që në të ardhmen institucioni të vlerësojë mundësitë e paraqitjes së këtyre planeve të financimit në nivel njësie bazë dhe program studimi. (kriteri 2)

### ***Komenti i Institucionit***

*Institucioni e shpjegon situatën, në pasjen e vetëm një nëpunësi autorizues dhe zbatues në nivel institucioni edhe pse ka katër fakultete. Prej vitit 2019 ka filluar detajimi i buxhetit në nivel njësie kryesore e në 2021, mendohet të bëhet detajimi në nivel njësie bazë. (Evidenca 5)*

### **Argumentimi i GVJ**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Faqe 13

GVJ u njoh me argumentin që drejtorja e Financës paraqet, mbështetur mbi Evidencën 5 shtesë. GVJ vlerëson komentin e institucionit dhe pengesat që ka në pasjen e vetëm një punonjësi autorizues dhe zbatues, por pavarësisht argumentimit të Institucionit, GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të dhënë, sepse e ka dhënë vlerësimin, mbi praktikën dhe evidencat që institucioni ka vendosur në dispozicion, mbi kriteret e parashikuara në formatin e RVJ. GVJ i qëndron vlerësimit të parë të dhënë, komenti **nuk pranohet**.

### **23. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi IV.6 kriteri 4**

GVJ rekomandon hartimin dhe planifikimin e ndërhyrjeve të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit, për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij në vitet në vazhdim, sikundër kriteri 4 e kërkon

#### ***Komenti i Institucionit***

*Në objeksionet e tij institucioni argumenton se është duke hartuar rregulloren financiare dhe pjesë e saj është edhe mënyra e shpërndarjes së të ardhurave të krijuara nga stafi .Gjithashtu në kuadër të diversifikimit institucioni argumenton se ai është pjesëmarrës në projektin IPA CROSS BORDER GRECCE, I cili konsiston edhe në ngritjen e një inkubatori biznesi nga I cili departamenti do të gjenerojë fonde duke ofruar shërbime për të tretët me pagesë.*

#### **Argumentimi i GVJ**

RVJ mbasi u njoh me komentet e institucionit si dhe me informacionin shtesë të sjellë në këtë fazë pas njohjes me draft RVJ dhe vlerëson pozitivisht, incentivat e para për parashikimin në rregulloren financiare të mënyrës së shpërndarjes së të ardhurave sipas njësive kontributorë, por edhe të ngritjes në të ardhmen të inkubatorit të biznesit dhe gjenerimit të të ardhurave shtesë.

GVJ inkurajon institucionin në intensifikimin e këtyre iniciativave **dhe pranon komentet** e institucionit, të cilat mund të ishin dhënë, qysh në fazat e mëhershme të procesit të vlerësimit, si pjesë e RVB.

### **24. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi V.4 kriteri 2**

GVJ rekomandon që institucioni të garantojë një përfshirje më të lartë dhe më aktive të studentëve në aktivitete të ndryshme vendimmarrëse dhe këshilluese, me qëllim plotësimin e interesave të tyre. Angazhimi i studentëve duhet të jetë më konkret, më i verifikueshëm dhe i matshëm.

#### ***Komenti i Institucionit***

*Në përmbushje të kriterit dhe në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP argumenton: Studentët janë në fokus të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit dhe si rrjedhim, angazhimi i tyre në proceset e vendimarrjes, këshillimit apo vlerësimit të institucionit nuk është fiktiv por real e i mbështetur në evidenca dhe rezultate të matshme.*

*Përvec garantimit të përfaqësisë së studentëve në organet kolegjiale si Senati Akademik (2 studentë përfaqësues) apo në komisionet e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë për çdo njësi Kryesore dhe në nivel Institucioni (studentët përfaqësohen me një anëtar në çdo komision), në UV studentët janë dhe pjesë e pandarë e komisioneve të ndryshme ad-hoc, të ngritur me qëllim hartimin apo përmirësimin e instrumenteve për sigurimin e cilësisë në UV, apo komisioneve për përzgjedhjen e bursave Erasmus+.*

*Një tjetër evidencë e angazhimit të studentëve është dhe pjesëmarrja e tyre në fushatat promovuese të programeve të UV-së në Open day apo organizime të ngjashme, ku vetë studentët si ambasadorët më të mirë të UV promovojnë programet e studimit tek maturatët.*

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ vlerëson informacionin e përcjellë nga institucioni për këtë kriter. Gjatë vizitës në institucion dhe në takimet me studentët, ata nuk kishin aplikuar për programe shkëmbimi, nuk kishin informacion rreth tyre dhe nuk rezultnin të ishin pjesë e komisioneve të përzgjedhjes. Informacioni dhe roli edhe i studentit të përfshirë në GVB ishte minimalist.

**GVJ i qëndron vlerësimit të parë të dhënë**

### **25. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi V.4 kriteri 4**

Mbështetur në këto statistika, GVJ është e mendimit që drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, të analizojnë këto të dhëna vjetore dhe të hartojnë një plan për të siguruar një stabilitet në rregjistrime në vitet e ardhshme.

#### ***Komenti i Institucionit***

*Institucioni argumenton se rënia e regjistrimeve, ka ardhur si pasoje e kufirit të vendosur për mesataren si dhe nga tkurrja e popullsisë, po pavarësisht kësaj institucioni promovon vazhdimisht programin e studimit jo vetëm në qytetin e Vlorës, por edhe më gjerë, në rajonin e Jugut.*

### **Argumentimi i GVJ**

Institucioni ia atribuon rënien e numrit të regjistrimeve, vendosjes së mesatares për regjistrim në fakultet të maturantëve, si dhe faktorëve demografikë dhe argumenton se e ka objektiv stabilitetin e numrit të studentëve dhe në mënyrë të vazhdueshme, promovon programin e studimit jo vetëm në qytetin e Vlorës, por edhe në rrethe të tjera të jugut.

GVJ vlerëson pozitivisht aktivitetin promovues të institucionit për PS Bsc në AB dhe inkurajon që në të ardhmen këto aktivitete të intensifikohen. Për sa më sipër komenti **pranohet**.

### **26. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi V.5 kriteri 4**

GVJ vlerëson përfshirjen e studentëve në anketat e zhvilluar për vlerësimin e procesit mësimor, megjithatë rekomandohet që krahas zhvillimit të pyetësorit të përdoren edhe instrumenta të tjerë në funksion të përmirësimit të programit. Psh, zhvillimi i fokus grupeve, apo mbledhjeve të hapura të departamenteve etj. Këto mund të shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi dhe përmirësimin e tij në vazhdimësi nëse pyetësorët nuk e ofrojnë këtë informacion

#### ***Komenti i Institucionit***

*Institucioni argumenton se ndryshimet në programet mësimore janë bërë në përputhshmëri me bazën ligjore dhe me studimet e tregut gjatë viteve 2017 dhe 2019 (komenti 2 evidencat edhe për komentin 23)*

## Argumentimi i GVJ

RVJ vlerëson pozitivisht që institucioni në mënyrë të vazhdueshme garanton përputhshmërinë e programeve mësimore, me ndryshimet në bazën ligjore dhe me studimet e tregut, ku në fazën e përcjelljes së komenteve, argumenton se në këtë studim tregu, përveç punëdhënësve kanë përfshirë edhe studentët. Për sa më sipër GVJ, vendos të pranojë komentin e institucionit, duke pasur besim se në të ardhmen përfshirja e studentëve do të jetë edhe më aktive dhe më e dokumentuar.

### 27. Paragrafi në draft RVJ

#### Standardi VI.1 kriteri 1

GVJ rekomandon që: veprimtarinë e saj NJSBCVI-ja ta zhvillojë sipas një plani kalendarik të përvitshëm, në të cilin programon monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse duke mos u ndalur vetëm tek pyetësorët e studentëve.

#### *Komenti i Institucionit*

*Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP komenton: NJSBCVI e organizon veprimtarinë e saj në bazë të një plani pune vjetor të miratuar dhe në mënyrë periodike raporton pranë titullarit të institucionit, ku hollësisht përshkruhen aktivitetet e realizuara në përputhje me planin vjetor të punës. Njëkohësisht në mënyrë të përvitshme NJSBCVI përpilon Raportin vjetor të punës si pjesë integrale të Raportit Institucional në përputhje me Udhëzimin e MASR Nr. 5 datë, 19.02.2018, si dhe raporton vazhdimisht mbi aktivitetet që organizon në kuadër të përmirësimit të cilësisë.*

*Vlen të theksohet se monitorimi i planit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit ka qenë një instrument shumë i rëndësishëm për NJSBCVI-në për vlerësimin e sektorëve të përfshirë në këtë plan. Pasi sikurse është përmendur edhe në RVB ky plan është mjaft i detajuar, ku për çdo rekomandim përshkruhen hollësisht aktivitetet që do të realizohen për përmbushjen e tij, Instrumenata që do të përdoren, Fazat e implementimit, Rezultatet e Pritshme, strukturat e përfshira, afati i realizimit si dhe evidencat të cilat dëshmojnë realizimin e aktivitetit .*

*Në Universitetin e Vlorës monitorimi i vermitarive të sektorëve realizohet prej Njesisë së Auditimit të Brendshëm, e cila është ngritur me Vendim Senati Nr. 8, datë 14.02.2019. Ajo ushtron veprimtarinë e saj mbështetur në programin vjetor të sektorit. Për vitin akademik 2018-2019 janë realizuar tre auditime në sektorët:*

- 1. Drejtorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional;*
- 2. Drejtorja e Edukimit të Ciklit të Parë dhe të Dytë,*
- 3. Drejtorja e Shërbimeve mbështetëse, Sektori i Shërbimeve.*

*Për secilin prej sektorëve, të sipërcituar Njësia e Auditimit ka lënë rekomandime përkatëse për përmirësimin e punës dhe arttijen e objektivave të Institucionit duke u bazuar në kuadrin ligjorë, detyrat dhe përgjegjësitë etj.*

## Argumentimi i GVJ

Me informacionin e ri të vendosur në dispozicion, GVJ pranon komentin e institucioni

### 28. Paragrafi në draft RVJ



## **Standardi VI.1 kriteri 2**

Pavarësisht për sa më sipër, GVJ sugjeron që pyetësoni të zhvillohet i veçantë për cdo modul/lëndë, leksione/seminar dhe cdo pedagog. Aktualisht ky pyetëson zhvillohet në mënyrë të përmbledhur për të gjithë pedagogët dhe modulet.

Po kështu nga konsultimi i pyetësonit për matjen e performancës së pedagogut konstatojmë që mënyra se si ky pyetëson është hartuar vështirëson matjen e performancës. Fushat që do të vlerësohen dhe indikatorët përkatës nuk janë të qarta për të arritur në rezultate të përdorshme në lidhje me performancën e stafit akademik ose jo akademik.

### ***Komenti i Institucionit***

*Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP saktëson: Në fund të çdo semestri, NJSBCVI nëpërmjet UVMS, organizon pyetësonin studentor për cilësinë e mësimdhënies për cdo lëndë/modul dhe pedagogun e lidhur me lëndën/modulin për cdo program studimi. Rezultatet të cilat gjenerohen prej sistemit UVMS-së pasqyrojnë rezultatet për cdo pedagog dhe për cdo lëndë, për më tepër jeni të lutur ti referoheni një modeli të rezultateve të pyetësonit i cili gjendet bashkëlidhur. Në këtë pyetëson paraqitet Emri i Pedagogut, Kodi i Lëndës, Programi i Studimit ku zhvillohet lënda, numrii studentëve që kanë plotësuar pyetësonin, numrii studentëve të rregjistruar në këtë lëndë, si dhe për cdo pyetje paraqitet përqindja e përgjigjeve të studentëve për cdo përgjigje, njëkohësisht në fund të pyetësonit gjenden të gjitha komentet e studentëve për dy pyetjet e hapura se çfarë vlerësojnë në programin e studimit dhe çfarë do të dëshironin të përmirësonin. Të dhënat e dala prej këtij pyetësoni përmbledhen në një raport analitik, i cili ka për qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, praktikat më të mira si dhe duke shërbyer si një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme. Krahas raportit që u përcillet njërive kryesore/ bazë nëpërmjet të cilit sigurohet një informacion i detajuar për cdo lëndë dhe cdo pedagog, NJSBCVI në faqen zyrtare elektronike të Universitetit “Ismail Qemali” e publikon këtë raport duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.*

*Përsa i përket konstatimit të GVJ mbi hartimin e pyetësonit, sqarojmë se tashmë ka filluar puna për përmirësimin e pyetësonit. Si një prej pikave të Planit të Masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies miratuar me Vendim Senati nr. 17 datë 23.03.2019, me Urdhër të Rektorit 123 datë 19.12.2019 është ngritur grupi i punës, i cili më datë 17.01.2020 ka mbajtur mbledhjen e tij të parë.*

### **Argumentimi i GVJ**

Institucioni paraqet nje evidencë shtesë në fazën e komenteve, një formë tjetër pyetësoni nga ajo e vendosur në dispozicion më herët, të cilës i është referuar edhe GVB, dhe që është miratuar nga senati në 2017. Për GVJ është e paqartë lidhja mes dy pyetësorve. GVJ si dhe GVB është mbështetur në Evidencën 6.6 në DVV, dhe jo kësaj forme pyetësoni të sjellë në fazën e komenteve.

GVJ pranon komentin e institucionit në këtë fazë, por është e mendimit që këto të dhëna duhet të ishin referuar që në RVB dhe të ishin vendosur në dispozicion të GVJ dhe të mos krijonin asimetri informacioni.

Fakti që institucioni ka filluar punën për përmirësimin e pyetësonit vlerësohet nga GVJ dhe dëshmon se është sinkron me gjetjen që GVJ ka konstatuar

Komenti i institucionit pranohet pjesërisht

## 29. Paragrafi në draft RVJ

### Standardi VI.2 kriteri 3

UV përdor metodologji vlerësimi mbështetur kryesisht tek instrumenti i pyetësorit prej të cilit synon të sigurohet një feedback për ecurinë e PS. Pyetësorë të tillë janë aplikuar për dy vite 2017-2018 si dhe 2018-2019, duke qenë se NJSBCVI është një strukturë relativisht e re GVJ, rekomandon diversifikimin e mekanizmave dhe instrumentave vlerësuese, si fokus grupe me studentët, vlerësim të stafit për ecurinë e programit dhe kapaciteteve institucionale për mbarëvajtjen e PS etj.

#### *Komenti i Institucionit*

*Në përmbushje të kriterit dhe në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP komenton: Vlerësimi i brendshëm i ecurisë së programit të studimit dhe aspekteve të tjera të lidhura me të nuk mbështetet vetëm në Raportin e analizës së pyetësorëve të studentëve por gjithashtu në:*

- *Raportet Vjetore të njëjësive bazë/ kryesore dhe strukturave në rektorat, ku përshkruhet një analizë e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor me të gjitha komponentet dhe elementet e tij;*
- *Nëpërmjet kontakteve të studentëve me këshilltarin akademik.*
- *Diskutimi në auditor i pedagogëve me studentët.*
- *Informacioni i përpunuar prej Sektorit të Këshillimit të Studentëve dhe Alumni-t. Statistikat mbi punësimin e studentëve dhe lloji i punës dhe karriera e tyre, janë një tregues mbi cilësinë e programeve të Studimit të ofruar prej këtij universiteti.*
- *Përfshirja e bashëpunorëve të jashtëm në organizmime të tilla si Wëorkshop-i me temë “Studentët dhe tregu i punës” i cili kishte për qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashëpunorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni. Objektivat kryesor të këtij workshop-i ishte: Vlerësimi i efektivitetit të programit të studimit nëpërmjet analizës nëse programi i studimit ka arritur të siguroj me kompetencat e duhura profesionale studentët e diplomuar; Identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta në programet e studimit, nxjerja e rekomandimeve për tejkalimin e këtyre të fundit.*

*Të gjithë dokumentat e sipër cituar shërbejnë për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit dhe aspekteve të tjera të lidhura me të, duke e bërë të larmishëm procesin.*

#### **Argumentimi i GVJ**

GVJ i referohet kriterit për ekzistencën e një metodologjie, që nënkupton mekanizma të ndryshëm të integruar në një model. Elementët që NJSBCVI paraqet në koment, janë mekanizma diskret, shpesh herë sporadik dhe nuk ka informacion se çfarë vlerësimi bëjnë, se ku raportojnë, se çfarë masash janë marrë prej tyre, të cilat duhet të sanksionohen në rregulloren e Njsbc.

Për sa më sipër komenti nuk merret parasysh

## 30. Paragrafi në draft RVJ

### Standardi VI.2 kriteri 5

GVJ nuk hasi në një raport të vlerësues për zbatimin e masave të lëna as për vitin 2017-2018 dhe as për

vitin 2018-2019. GVJ rekomandon që institucioni të ndjek zbatimin e masave të propozuara nga njësitë kryesore dhe të miratuara nga senati për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

### ***Komenti i Institucionit***

*Në përmbushje të kriterit dhe në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP komenton: Në mënyrë të vazhdueshme institucioni monitoron zbatimin e planit të masave. Strukturat e ngarkuara në Vendimin e Senatit përkatës të Planit të Masave për vitin akademik zbatojnë dhe raportojnë mbi përmushjen e planit të masave duke i bërë pjesë integrale të raporteve të tyre të punës. Njëkohësisht NJSBCVI, ka përcjellë pranë autoriteve drejtuese të UV-së një raport të detajuar mbi realizimin e veprimtarive të parashikuara në këtë plan masash sëbashku me evidencat përkatëse. Ndërkohë që Plani i Masave për rezultatet e pyetësorëve të vitit akademik 2018-2019 është në proces diskutimi prej strukturave të përcaktuara në procedurë.*

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ i referohet raportit të zbatimit të masave në nivel programor. Dokumentat e vendosura në dispozicion nga institucioni në këtë fazë, (dok. 25), raporton për ndryshim pyetësori, hartim pyetësori për stafin ndihmës akademik etj, por në asnjë nga këto raporte, nuk identifikohen ndërhyrje si rezultat i problematikave të dala nga vlerësimi i brendshëm në nivel programor

Për sa më sipër komenti nuk merret parasysh

### **31. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi VI.3 kriteri 4**

*Pyetësor i cili zhvillohet në fund të vitit akademik në mënyrë të përgjithshme për të gjithë lëndët por jo në mënyrë të veçantë për secilin prej moduleve. Kjo praktikë e ndjekur pengon identifikimin e problematikave specifike për secilin modul.*

### ***Komenti i Institucionit***

*Në përmbushje të kriterit dhe në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP: Ashtu sikurse është sqaruar edhe më sipër në Standartin VI.1 Kriteri 2, në fund të semestrit studenët vlerësojnë cdo lëndë/ modul që kanë frekuentuar. Njëkohësisht në Raportin e Analizës së Pyetësorëve i cili ju përcillet Njësive Kryesore dhe më tej Njësive Bazë, për cdo program studimi, për secilën prej pyetjeve paraqiten rezultatet e përgjigjeve të studentëve për cdo lëndë dhe cdo pedagog në formë tabelare.*

*Njëkohësisht rezultatet e pyetësorëve, për cdo pedagog dhe cdo lëndë që gjenerohet prej sistemit pasqyrohen si rezultatet e 14 pyetjeve të mbyllura edhe komentet e studentëve në pyetjet e hapura.*

*Vlen të theksohet se po në këtë raport në Seksionin e Përfundimeve dhe Rekomandimeve, NJSBCVI-së për cdo program studimi realizon edhe një analizë krahasuese midis përgjigjeve të studentëve në lëndë të ndryshme brenda të njëjtës pyetje duke evidentur ato lëndë ku diferenca midis mesatares aritmetike dhe rezultateve të lëndëve specifike është sëpaku dy herë më e lartë. Më konkretisht:*

- *Nëse në nivel programi studimi vetëm 3.9% e studentëve nuk ishin aspak dakort dhe dakort me qëndrimin “Mësimi ishte Interesant”, në disa prej lëndëve të programit rezultati për po të njëjtat përgjigje është sëpaku dy herë me I lartë: 11.76%, 8.82%, 13.51%, 12.5% ( për më tepër jeni të lutur ti referoheni tabelës nr. 5)*

- Nëse në nivel programi studimi vetëm 3.8% e studentëve nu ishin dakort dhe aspak dakort me qëndrimin “ Qëllimi i mësimi u shpreh qartë”, në disa lëndë të programit të studimit rezultati është : 12.12%, 12.5%, 10.81%, 8.82% ( Tabela nr. 6)
- Në lidhje me qëndrimin “Pedagogu ishte I qartë”, në nivel programi studimi 3.6% e studentëve nuk ishin dakort dhe aspak dakort me qëndrimin, ndërkohë që në disa prej lëndëve rezultati ishte relativisht më I lartë, më specifikisht: 12.5%, 10.81%, 8.82%, 7.69% ( jeni të lutur ti referoheni tabelës nr. 7)
- Nëse në nivel programi studimi vetëm 6.7% e studentëve nuk ishin dakort me qëndrimin “Pedagogu Inkurajonte dialogun/diskutimin në klasë” në disa prej lëndëve rezultatet për po të njëjtat përgjigje ishin së paku dy herë më të lartë: 15.15%, 24.33%, 17.5% etj( Tabela nr. 9)
- Nëse në nivel programi studimi vetëm 3.8% e studentëve nuk ishin dakort dhe aspak dakort me qëndrimin “Pedagogu është gjithnjë i përgatitur”, në disa prej lëndëve ashtu sikurse edhe qëndrimt e tjera të kategorizuara në këtë grupim ishin sëpaku dy heër më të larta më specifikisht: 7.5%, 12.5%, 16.67%, 8.82%, 10% etj. ( Tabela nr. 11)
- Nëse në nivel programi studimi mesatarja aritmetike e studentëve që nuk ishin dakort dhe aspak dakort me qëndrimin “Pedagogu inkurajonte mendimin kritik” ishte 8.8% në disa prej lëndëve rezultati për po të njëjtat përgjigje është konsiderueshëm më i lartë : 33.33%, 24%, 18.92%, 23.34% ( Tabela nr. 12)
- Nëse në nivel programi studimi vetëm 4.6% e studentëve nuk janë dakort dhe aspak dakort me qëndrimin “Pedagogu e bën lëndën interesante” në disa prek lëndëve rezultati i përgjigjeve të studentëve është 12.5%, 13.51%, 13.33%, etj ( tabela nr.14)

Nga sa më sipër mund të konkludojmë se identifikimi i lëndëve/ moduleve dhe pedagogëve ku rezultatet janë më pak pozitive dhe mund të hasen problematika specifike janë lehtësisht të identifikueshëm.

### **Argumentimi I GVJ**

GVJ nuk gjeti informacion të ri në lidhje me vlerësimin e kij kriteri, që paraqitet për mekanizmat e tjerë të tërthortë përtej pyetsorit, në komentin e institucionit. Vlerësimi I GVJ këtu është dhënë mbi mekanizma të tjerë të tërthortë përveç pyetësorit. Ndërsa për formatin e pyetësorit, GVJ është shprehur në standardet VI.2 kriteri 2 dhe reflektohet edhe këtu, por nuk ndikon në vlerësimin e kriterit

### **32. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi VI.4 Kriteri 1, 5**

GVJ nuk gjeti evidence për përfshirjen e stakeholdersve të jashtëm me fokus përmirësimin e cilësisë së PS BA AB si p.sh të Përfaqësuesve të Biznesit, të shoqatave të biznesit, të institucioneve publike, vendimmarrës lokal etj.

GVJ nuk gjeti praktika të përfshirjes më aktive ne proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.

#### **Komenti i Institucionit**

*Në përmbushje të kriterit dhe në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP komenton: Me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjes sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, nëpërmjet ndarjes së eksperiencës ndërmjet bashkëpunëtorëve,*

ekspertëve të jashtëm dhe Alumnit më datë 18.12.2019 u organizua Ëorkshopit me temë “ Studentët dhe tregu i punës”. Objektivat e takimit ishin:

- Vleresimi i efektivitetit të programit të studimit nëpërmjet analizës nëse programi i studimit ka arritur të siguroj me kompetencat e duhuar profesionale studentëve të diplomuar.
- Fuqizimi i rrjetëzimit midis universitetit dhe bashkëpunorëve të jashtëm.
- Identifikimi i pikave të forta dhe të dobta në programet e studimit, nxjerja e rekomandimeve për tejkalimin e këtyre të fundit

I organizuar në trajtën e një tavoline të rrumbullakët pjesëmarrësit, kryesisht Institucionene Publike si Zyra e Punës, Drejtoria e Tatimeve, Prefektura, Zyra Arsimore, Dhoma e Tregtisë, Përfaqësues i Shoqatës së Operatorëve Turistik në Vlorë, drejtues të Bankave ë Nivelit të Dytë në Qytetin e Vlorës etj, dolën me një paketë rekomandimesh ku dy prej tyre i drejtoheshin në mënyrë specifike Programeve që ofronte Fakulteti i Ekonomisë, duke përfshirë edhe programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi:

- Krijimi i rrjetëzimit funksional bashkëpunimi midis Universitetit dhe Bizneseve, e tillë si Qendra e Asistencës së Biznesit duke rritur kështu mundësinë e punësimit të studentëve si dhe realizimin e praktikave profesionale. Këto të fundit do të ndikojnë në përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit nëpërmjet ndërthurjes së teorisë me praktikën.
- Pajisja e studenëve me instrumentat e nevojshme për të qënë të përgatitur dhe të konkurrueshëm me tregun e punës nëpërmjet trajnimeve, konfenrecave etj. Pjesëmarrësit sugjeruan integrimin në kurrikulat e programeve të studimit lëntë të cilat aftësojnë studentët si të kenë një qasje më pozitive gjatë përballjes me problem të ndryshme në mjedisin e punës, si të përgatisin një jetëshkrim profesional, si të realizojnë një intervistë pune të sukseshme, puna në grup etj.

Ky aktivitet është një dëshmi e drejtpërdrejtë e përfshirjes së bashkëpunorëve të UV-së, ekspertëve dhe punëdhënësit kryesor të studentëve sipas fushave rezpektive me qëllim përmirësimin e kurrikulës së programeve të studimit. Duke marrë në konsideratë suksesin e këtij aktiviteti, tanimë UV-ja ka vendosur ta organizojë atë në mnyrë të përvitshme duke e organizuar në nivel Njësie Kryesore.

### **Argumentimi i GVJ.**

GVJ në përmbushje të kriterit 1, nuk gjeti evidencë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë për përfshirjen e stakeholdersve të jashtëm. Prandaj paragrafi i kriterit 1 nuk ndryshon.

GVJ vlerëson këtë iniciativë që institucioni ka ndërmarrë, por thekson se ky aktivitet fokusin kryesor e ka tek studentët dhe tregu, siç thuhet në komentin e institucionit dhe nese organizohen me efektivitet, mund të japin një feed-back edhe për përmirësimin e cilësisë në programin e studimit. Aktiviteti në fjalë, nuk rezulton të ketë dhënë ndonjë impakt, por është një hap pozitiv i institucionit drejt përmbushjes së kriterit 5

Komenti pranohet pjesërisht

### **33. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi VI.4 Kriteri 3**

Pavarësisht se NJSBCVI ka detyrimin institucional për ndjekjen e procedurave për sigurimin e Brendshëm të cilësisë, duke iu referuar raportit të analizës së gjetjeve për 2018-2019, konstatohen se gjetjet dhe analizat janë të përgjithshme, nuk janë të detajuara për një pyetësor me 16 pyetje që aplikohet,

e gjithashtu ato nuk analizohen në nivel program studimi.

### ***Komenti i Institucionit***

*Në përmbushje të kriterit dhe në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP komenton: Në Raportin e Analizës së Pyetësorëve si për vitin akademik 2018-2019 edhe për vitin akademik 2017-2018, për cdo program studimi analizohen në mënyrë të hollësishme rezultatet e pyetësorëve të organizuar në dy seksione të cilat përkohë njëllojësisht me organizimin e pyetësorit. Për secilën pyetje është pasqyruar grafikisht mesatarja aritmetike e përgjigjeve për programin e studimit (si mesatare aritmetike e përgjigjeve për secilën lëndë e shprehur në përqindje) si dhe tabela e hollësishme e përgjigjeve të studentëve për secilën lëndë në veçanti. Ndërkohë që përgjigjet e pyetjeve të hapura janë pasqyruar në seksionin e rekomandimeve dhe sugjerimeve duke i cituar sikurse janë përgjigjur studentët.*

*Vlen të theksohet se me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit dhe në respect të lirisë dhe etikës akademike dhe Ligjit Nr. Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" në faqen zyrtare elektronike të Universitetit "Ismail Qemali" publikohet vetëm mesatarja aritmetike për cdo pyetje në nivel programi studimi. Ndërkohë që të dhënat e hollësishme për cdo lëndë dhe cdo pedagog në nivel programi studimi, ashtu sikurse është përshkruar edhe në RVB e PS Bachelor në Administrim Biznesi, ju përcillen njësisë Kryesore të cilat realizojnë më tej një konsultim të gjerë me stafin akademik, duke e bërë të gjithë procesin e përmirësimit të programit të studimit nëpërmjet pyetësorit të studentëve transparent dhe gjithëpërfshirës.*

*Njëkohësisht në Raportin e Analizës së Pyetësorëve të publikuar në faqen e Web-it të UV-së gjenden rekomandimet dhe gjetjet për cdo program studimi, më konkretisht për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi për vitin akademik 2018-2019 gjenden në faqet 143-148 si dhe për vitin akademik 2017-2018 në faqet 54-55.*

### **Argumenti i GVJ**

GVJ vlerëson punën e realizuar nga struktura e NJSBCVI deri tani në nivel institucional, e vënë kjo në dukje edhe gjatë takimit në institucion. Në kuadër të një vlerësimi programor, kur institucioni ka një numër të lartë programesh, është praktikisht e pamundur nga ana e kësaj strukture realizimi i të gjithë proceseve, por njëkohësisht është e nevojshme rritja e rolit të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Në këtë kuadër fokusi i rekomandimit të GVJ, konsiston një përfshirje më të madhe të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë në manaxhimin e proceseve për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe në specifikimin e tyre në nivel programor, ndërkohë që NJSBCVI ndjek procesin në nivel institucional, sepse edhe kriteri 3 këtë kërkon.

Për sa më sipër GVJ i qëndron të njëjtit rekomandim

### **34. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standarti VI. 5 Kriteri 4**

GVJ ndër të tjera komenton: GVJ nuk hasi në një raport të vlerësues për zbatimin e masave të lëna as për vitin 2017-2018 dhe as për vitin 2018-2019.

### ***Komenti i Institucionit***

*Në përmbushje të kriterit, DSBCP komenton: Në Raportin e Analizës së Pyetësorëve në Seksionin e Rekomandimeve dhe përfundimeve për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi një rëndësi të vecantë i kushtohet realizimit të një analize krahasuese midis rezultateve të dy viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, qëllimi i së cilës është matja e*

efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive të ndërmarra në kuadër të përmirësimit të cilësive të implementimit të planit të masave të miratur një vit më parë. Më konkretisht, nëse për vitin akademik 2017-2018, NJSBCVI rekomandon:

- Referuar rezultateve të pyetësorëve mbi qëndrimin: “Mësimi ishte i mërziqshëm”, ku mesatarja aritmetike për përgjigjen: totalisht dakort ishte 20.6 % e studentëve si dhe 13.7 % ishin dakort sugjerojmë: rishqyrtimin e literaturës në lëndë specifike si dhe implementimin e teknikave bashkëkohore mësimdhënëse me qëllim bërjen e lëndës ineresante për studentët, duke marrë në konsideratë gjithnjë specifikat e lëndëve përkatëse. Për identifikimin e të cilave sugjerojmë strukturat përkatëse ti referohen dhe komenteve e sugjerimeve të hollësishme të studentëve në raportin e përpunuar të pyetësorëve për secilën lëndë. Megjithatë vlen për tu theksuar se disa prej lëndëve janë vlerësuar pozitivisht prej ku është specifikuar veçanërisht risia e informacionit të marrë.
- Duke marrë shkas nga rezultatet e përgjigjeve të studentëve mbi qëndrimin: “Përmbajtja e lëndës ishte e vështirë”, ku përqindja e mesatares aritmetike të studeneve që ishin totalisht Dakort dhe Dakort me qëndrimin ishte respektivisht 35.9% dhe 32%, gjykojmë dhe sugjerojmë se është i nevojshëm adaptimi i disa teknikave apo përdorimi i disa intrumentave prej pedagogëve respektiv, të cilat do të lehtësonin procesin e mësimnxënies. Gjithashtu rishikimin e literaturës së përdorur në disa prej lëndëve të këtij programi studimi duke e përditësuar me literaturë më koherente.

Pas marrjes në konsideratë të rekomandimeve prej departameneve, praktikë e evidentuar edhe prej GVJ- së si rishikimi syllabuseve etj, konstatohen përmirësimet si më poshtë vijon:

- Krahasuar me vitin e mëprashëm akademik kemi një rënie prej 6.8% të studentëve që nuk ishin dakort dhe aspak dakort me qëndrimin “Pedagogu ishte gjithnjë I përgatitur”. Më specifikisht nëse në vitin 2018-2019, 3.8% e studentëve nuk ishin dakort dhe aspak dakort me qëndrimin për vitin akademik 2017-2018, rezultati ka qenë 10.6%.
- Nëse gjatë viti akademik 2017-2019, 15.4% e studentëve nuk ishin dakort dhe aspak dakort me qëndrimin “Pedagogu inkurajonte dialogun/dikutimin në klasë”, gjatë viti akademik 2018-2019, rezultatet bien konsiderueshëm në vlerën 6.7% të studentëve.

Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP është shprehur në përgjigjen e komentit të kriterit 5, standardi VI.2.

### **Argumentimi i GVJ**

Kriteri në fjalë, shprehet që Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Rekomandimi i GVJ jepet për këtë kriter për nivelin programor, për të cilin komenti i Institucionit nuk sjell informacion të ri.

GVJ i mbetet të njëjtit qëndrim

### **35. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standarti VI. 5 Kriteri 5**

Në të ardhmen GVJ sugjeron që NJSBCVI të hartojë plan të veprimtarive periodike senbilizuese/informuese që ato të mos jene sporadike dhe t'i dokumentojë ato,

#### ***Komenti i Institucionit***

*Në përmbushje të kriterit dhe në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP komenton: Në Planin e Punës Vjetor, NJSBCVI në mënyrë të përvitshme parashikon aktivitete dhe seminare informuese në trajtën e javëve sensibilizuese për përfshirjen e aktorëve të brendshëm në vlerësimin e programeve të studimit, cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës akademik dhe administrativ, më specifikisht në muajt Shkrut, Mars, Maj, Qershor, Tetor. Këto aktivitete kanë për qëllim të sensibilizojnë dhe orientojnë jo vetëm studentët e viteve të mëparshme por edhe studenët e rinjë të UV-së, duke i informuar ata mbi instrumentat që institucioni përdor për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit si dhe mbi rëndësinë e përfshirjes në këtë proces.*

*Parashikimi i këtyre aktiviteteve edhe për vitin 2020 është një dëshmi e drejtpërdrejtë e periodicitetit duke mos ngelur thjesht në kuadër të nismave sporadike.*

*Me qëllim dokumentimin e aktiviteteve të realizuara në përputhje të Planit të Punës, NJSBCVI raporton në mënyrë periodike pranë titullarëve të Institucionit, për më tepër jeni të lutur ti referoheni:*

- *raporteve tremujore të NJSBCVI-së, bashkëlidhur.*
- *raportit vjetor të punës si pjesë integrale e Raportit Institucional në përputhje me Udhëzimin e MASR Nr. 5 datë, 19.02.2018,*
- *si dhe raporteve specifike mbi aktivitete që organizohen në kuadër të përmirësimit të cilësisë.*

*Në të të tre tipet e dokumenteve të sipërcituara gjendet informacion edhe mbi aktivitet sensibilizuese/informuese në kuadër të përmirësimit të cilësisë, të cilat publikohen njëkohësisht edhe në faqen e Eëb-it si dhe në rrjetet sociale të UV-së.*

## **Argumentimi i GVJ**

Komenti i Institucionit merret parasysh duke iu referuar evidencave të përcjella.

### **36. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi VI.6 kriteri 4**

GVJ nuk mund të vërtetojë se cilat prej procedurave të mësipërme kryhen nga institucioni, metodologjinë që përdoret për to, periodicitetin e kryerjes etj.

GVJ rekomandon përdorimin e instrumenteve të drejtpërdrejtë nga institucioni, të tjerë të ndryshme nga pyetësi dhe dokumentimin e gjetjeve të tyre dhe hartimin e masave për adresim të problematikave

#### ***Komenti i Institucionit***

*Në komentin e institucionit për këtë kriter, institucioni ka sjellë informacion shtesë siç është evidenca 6. si dhe disa forma të tjera të mekanizmave të drejtpërdrejtë.*

## **Argumentimi i GVJ**

RVJ ka ngritur rekomandimin për institucionin pasi në DVV, nuk kishte një dokument të vlerësimit të performancës së stafit, të ndryshëm nga pyetësi apo edhe mekanizma të tjerë të cituar në këtë kriter, të përdorur nga institucioni. Edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ u përqendrua në sigurimin e informacionit për mekanizma të tjerë të vlerësimit të performancës, si p.sh nga shefi i departamentit, por nuk u siguroi. Ky informacion erdhi në fazën e paraqitjes së komenteve nga institucioni nëpërmjet evidencës 6, në të cilën paraqitet vlerësimi i performancës së stafit për disa fusha, për syllabusin, literaturën, për pjesëmarrjen në kërkimin shkencor dhe projekte, për procesin mësimor etj.

Për sa më sipër komenti me informacionin shtesë të sjellë në këtë fazë, **pranohet**.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Administrim Biznesi”

### I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë synon të përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit si dhe ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare akademike dhe kulturore.</p> <p>Kjo gjë shprehet qartë në Statutin e UV neni 3, pikat 2 a-ç ku theksohet se:</p> <p><i>“2. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë e zhvillon veprimtarinë në këto drejtime:</i></p> <p style="margin-left: 40px;"><i>a) Mësimdhënie bashkëkohore, sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare;</i></p> <p style="margin-left: 40px;"><i>b) Formim i specialistëve të lartë dhe përgatitje të shkencëtarëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit;</i></p> <p style="margin-left: 40px;"><i>c) Punë kërkimore-shkencore bazë dhe e aplikuar, si dhe veprimtari akademike të cilësisë së lartë;</i></p> <p style="margin-left: 40px;"><i>ç) Shërbime me ndikim në publik dhe në komunitet, si dhe shërbime për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, në nivel kombëtar dhe rajonal;</i></p> <p>Vizioni dhe Misioni i përcaktuar në Planin Strategjik Institucional 2018-2024, është në të njëjtën linjë me Statutin e UV.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë si dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të “Ekonomisë”.</p> <p>Ky program “synon të ofrojë një formim të shkëlqyer akademik për të përgatitur profesionistët e ardhshëm të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin rajonal dhe kombëtar”</p> <p><a href="#">(Evidenca A-Statuti i UV)</a></p> <p><a href="#">(Evidenca B-Plani Strategjik 2018-2024, fq. 22-24)</a></p> <p><a href="https://univlora.edu.al/fe-departamenti-i-administrim-biznesit/">(https://univlora.edu.al/fe-departamenti-i-administrim-biznesit/)</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit	UV përcakton në Planin Strategjik 2018-2024 se

<p>hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>“... vizioni kryesor i UV-së, është të ketë një ndikim transformues në shoqëri, përmes inovacionit të vazhdueshëm në arsim, hulumtim, kreativitetin të lartë dhe pjesëmarrjes aktive në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.”</p> <p>Ndër sektorët kryesorë ku UV synon të jetë drejtues dhe orientues i zhvillimit theksohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillimi social-ekonomik dhe kulturor i terrenit;</li> <li>- turizmi dhe biznesi;</li> <li>- inovacion dhe transferim i teknologjive;</li> <li>- rritja e konkureshmërisë dhe marketim i territorit;</li> <li>- nxitja dhe krijimi i sipërmarrjeve të reja nëpërmjet mekanizmave të spin off-it;</li> </ul> <p>Referuar dokumentave strategjike të UV-së si Statuti, Plani Strategjik e Rregullore si dhe nga vizita në institucion, GVJ konkludon se: programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të drejtimeve prioritar akademike të institucionit.</p> <p>Emërtimi, organizimi, struktura si dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” është në përputhje të plotë me misionin, vizionin dhe objektivat e zhvillimit si institucional ashtu dhe të FE dhe Departamentit të Biznesit. Në të janë përcaktuar qartë objektivat për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë përmes njohurive bazë ekonomike që marrin në përfundim të programeve të studimit.</p> <p>(Evidenca A-Statuti) (Evidenca B-Plani Strategjik 2018-2024) (Evidenca 1.3 - Plani Strategjik Departamenti i Biznesit) (Evidenca C-Rregullore UV e Ndryshuar) (Evidenca 2.5-Rregullore e Departamentit të Biznesit)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.3</b> <b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Në Rregulloren e Departamentit të Biznesit janë të përcaktuara në Nenin 2 Misioni dhe Objektivat e Departamentit në përgjithësi, por jo specifike për çdo program studimi.</p> <p>“Misioni i Departamentit të Biznesit është përgatitja, formimi dhe diplomimi i studentëve të aftë në fushën e biznesit, turizmit dhe marketingut në përputhje me trendet e tregut të punës në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin rajonal e kombëtar, por edhe në atë evropian e më gjerë. Duke ofruar një mjedis mësimor bashkëpunues që transmeton dhe zhvillon dijet nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ne edukojmë një komunitet të larmishëm të profesionistëve të biznesit aktual dhe të ardhshëm për t’u përballur me sukses me sfidat e mjedisit global të biznesit për të qenë menazherë, sipërmarrës dhe</p>



<p>përfitimim e dijeve, aftësi, shkathtësi e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p><i>specialistë dhe për të udhëhequr një karrierë të suksesshme.”</i> (Evidenca 2.5-Rregullore e Departamentit të Biznesit, Neni 2, fq.4-5)</p> <p>Ndërkohë në Supplementin e Diplomës dhe Planin Strategjik per Programin e Studimit Bachelor ne Administrim Biznesi 2020-2024 qartësohen objektivat e formimit të studentëve si më poshtë:</p> <p><i>“Programi i Studimit Bachelor në Administim Biznesi synon të përgatisë ekonomistë të profilit me njohuri bazë dhe të thelluara bashkëkohore për t’u adaptuar për llojet e ndryshme të biznesit, të aftë për të punuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, në përputhje me nevojat e tregut të punës. Të diplomuarit në Administrim Biznesi do të jenë në gjendje të përdorin dhe vlerësojnë mjetet për analizimin e kompanisë, të njohin kërcënëmet dhe mundësitë me të cilat përballet organizata në mjedise vazhdimisht të ndryshueshëm dhe global dhe të jenë në gjendje për marrjen e vendimeve optimale në nivele të ndryshme të administrimit të bizneseve.”</i></p> <p>(Evidenca 1.5-Suplement Diplome, fq. 2) (Evidenca 1.4- Planin Strategjik per Programin e Studimit Bachelor ne Administrim Biznesi 2020-2024)</p> <p>Gjatë vizitës në institucion rezultoi se i vetmi komunikim i Departamenti i Biznesit me tregun e punës është nëpërmjet arranzhimit të praktikave profesionale, si dhe institucioni nuk disponon informacion mbi punësimin e të diplomuarve të programit.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se studimet mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin Bachelor në “Administrim Biznesi”, nuk janë kryer në mënyrë periodike, por në funksion të thirrjeve për projekte. Vlen të theksohet studimi në kuadër të projektit “Fondi i Ekselencës” në vitin 2011-2012, me titull “Impakti në punësim i kurrikulave të nivelit të parë të studimeve pranë FE të UV”, i cili është i vetmi studim i mirëfilltë rreth analizës së impaktit të kurrikulave të UV në tregun e punës. Studime të tjera si projekti TRANS-EDU-NET (2017-2018), apo teza diplome kanë patur fokus të përgjithshëm të të diplomuarve dhe tregut të punës, por jo specifike të programit të studimit. Gjithashtu duke nisur nga viti akademik 2017-2028, Drejtoria e Edukimit te UV-se ka iniciuar gjurmimin e studenteve te punesuar ne profesion te te diplomuarve te UV-se.</p> <p>GVJ sugjeron që departamenti të kryejë studime periodike mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për çdo program të ofruar duke forcuar bashkëpunimin drejt ko-krijimit të vlerave si për industrinë (duke iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave të tyre), programin e studimit (duke reflektuar zhvillimet e fundit në planet mësimore) ashtu dhe studentët (duke ofruar mundësinë e aftësimin dhe përgatitjes së tyre sipas nevojave të tregut si dhe rritur mundësitë e punësimit).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi I.4**  
**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>UV është i organizuar në katër fakultete: (1) Fakulteti i Ekonomisë; (2) Fakulteti i Shëndetit Publik; (3) Fakulteti i Shkencave Humane; (4) Fakulteti i Shkencave Teknike.</p> <p>Programi Bachelor në “Administrim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Biznesit, i cili operon nën FE.</p> <p>Referuar statistikave të raportuara tabelore, FE ka në përbërje të tij për vitin akademik 2019-2020, 33 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE) nga ku Departamenti i Biznesit ka 16 anëtarë PAE, ndër të cilët 15 janë me gradë shkencore /titull akademik.</p> <p>Për këtë vit akademik programi Bachelor “Administrim Biznesi” mbulohet 100% nga PAE duke përbushur kushtin ligjor (VKM nr. 418, datë 10.05.2017), të mbulimit të programit të studimit me 70% me pedagogë të brendshëm.</p> <p>(Aneks I, Tabela 1 Numri i personelit akademik për çdo njësi baz. (Evidenca 2.9- Kapacitet Akademike dhe Kapacitetet Fizike Infrastrukturore të FE) (Evidenca 2.16 CV-të e Personelit Akademik pranë Departamentit të Biznesit)</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Departamenti i Biznesit ofron studime në tre programe të ciklit të parë bachelor: (1) Bachelor në Administrim Biznesi, (2) Bachelor në Manaxhim Turizmi, (3) Bachelor në Marketing.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Biznesit si dhe të FE, dhe i shërben misionit që ato mbartin.</p> <p>Nga sa më sipër GVJ konkludon se, programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” operon në kuadër të kornizave ligjore dhe ligjit të arsimit të lartë 80/2015. Ky program është në përputhje me nivelin 7 të kornizës evropiane dhe shqiptare të kualifikimit. Strukturat operationale të institucionit mundësojnë arritjen e misionit të UV si edhe përbushjen e objektivave të tij.</p> <p>(Evidenca B-Plani Strategjik 2018-2024) (Evidenca 1.3 - Plani Strategjik Departamenti i Biznesit) (Evidenca C-Rregullore UV e Ndryshuar) (Evidenca 2.5-Rregullore e Departamentit të Biznesit) (Evidenca 1.7-Struktura Organizative)</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi I.5**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit Bachelor në “Administrim Biznesi”, UV është e përcaktuar si në rregulloret e brendshme si institucionale ashtu edhe të Departamentit të Biznesit ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë midis njësisë të ndryshme. Duhet theksuar se pesha kryesore mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin, Departamenti i Biznesit. Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Biznesit në mbështetje të nenit 32 të Ligjit nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit të MASR, nr. 5, date 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” ka hartuar dhe raportuar në FE dhe rektorat, Raportin Vjetor sipas elementeve përbërës të raportimit vjetor.</p> <p>(Evidenca C-Rregullore UV e Ndryshuar) (Evidenca 2.5-Rregullore e Departamentit të Biznesit) (Evidenca 1.7-Struktura Organizative) (Evidenca 2.3 Vendim për Emërimin e Përgjegjasve të grupeve mësimore në Departamentin e Biznesit) (Evidenca 2.4 Emërimi Koordinatori për marrëdhëniet me studentët) (Evidenca 1.9 Raporti Vjetor Departamenti i Biznesit)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni ka vendosur marrëdhënie të ndryshme bashkëpunimi në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor të programit Bachelor në “Administrim Biznesi”.</p> <p>GVJ vlerëson bashkëpunimet e raportuara në RVB me institucione të shumta homologe jashtë vendit të cilat kanë kontribuar në shkëmbimin e eksperiencave, kualifikimin e stafit mësimdhënës, dhe zhvillimin e punëve kërkimore të përbashkëta. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se këto marrëveshje bashkëpunimi nuk kanë rezultuar po aq të dobishme për studentët e UV, pasi asnjë student i programit Bachelor në “Administrim Biznesi” nuk ka shfrytëzuar mundësitë e mobilitetit, për arsye personale apo për mos përmbushje të kriterit të gjuhës angleze, ndërkohe që për vitin akademik 2019-2020 rezultojnë dy student të ardhur nga Rumania.</p> <p>GVJ konstaton se bashkëpunimi me aktorët e biznesit vendas i programit në fjalë është vetëm në kuadër të praktikave profesionale. GVJ rekomandon që programi i studimit të shtojë larmishmërinë dhe numrin bizneseve, (pasi një pjesë rezulton të jenë furrë buke, market e kafene) si inkorporimin e një bashkëpunimi sinergjik në kuadër të ko-krijimit të vlerave për të gjithë aktorët në fjalë. Nga dokumentacioni i dorëzuar nuk rezulton që programi të ketë bashkëpunim me aktorë të biznesit të huaj.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Biznesit në mbështetje të nenit 32 të Ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Udhëzimit të MASR, nr. 5, date 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” ka hartuar dhe raportuar në FE dhe rektorat, Raportin Vjetor sipas</p>



	<p>elementeve përbërës të raportimit vjetor ku përfshihen edhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimit të këtij departamenti.</p> <p>(Aneksi I Tabela 5 Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë) (Evidenca 1.9 Raporti Vjetor Departamenti i Biznesit)</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Në Statutin e UV është përcaktuar se trajnimet profesionale të edukimit të vazhdueshëm për institucionin do të ofrohen nga Qendra studimore ndërdisiplinore.</p> <p>GVJ konstaton se nuk janë raportuar evidenca lidhur me trajnimet profesionale të ofruara në bashkërendim me punëdhënësit për studentët e diplomuar. (Evidenca A- Statuti UV, neni 12, pika c)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznes”, rezulton të jetë i organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe konsultuar, ekspertët konstatojnë se programi Bachelor në “Administrim Biznesi” është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS secili vit; në total 180 ECTS. Studentit i ofrohen nga 10 lëndë gjatë vitit të parë dhe të dytë akademik, ndërsa në vit të tretë 11 lëndë ku janë të përfshira Praktika Mësimore si dhe Provimi Përfundimtar ose Teza e Diplomimit.</p> <p>Rezultojnë ndryshime rahasuar me planin mësimor të liçencuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 19 lëndë ndryshime në ECTS;</li> <li>- 1 lëndë ndryshim në Disiplinë;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 lëndë me zgjedhje shtohet;</li> <li>- 1 lëndë e vitit të tretë kalohet në vit të parë;</li> <li>- Përkrah Tezës së Diplomimit shtohet mundësia e Provimit Përfundimtar.</li> </ul> <p>(Aneks I, Tabela 10 Plani mësimor) (Aneks I, Tabela 11 Ndryshimet në planin mësimor krahasuar me programin e licencuar) (Evidenca 2.12 Përcjellje e riorganizimit të programeve të studimit “Bachelor në Administrim Biznesi”)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”, synon t’u ofrojë studentëve një formim të gjerë në llojshmëri të profesioneve e specialitetëve si në sektorin publik ashtu edhe atë privat e jofitimprurës, nëpërmjet lëndëve si Menaxhim operacionesh, Financë, Makroekonomi, Teknologji informacioni, Marketing, Kontabilitet, Statistikë etj.</p> <p>(Aneks I, Tabela 10 Plani mësimor)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Pas shqyrtimit të përmbajtjes së Planeve Mësimore, Syllabuseve të lëndëve, Literaturës së miratuar nga departamenti, Strategjisë së zhvillimit të programit mësimor, si dhe takimeve të ndryshme gjatë vizitës në institucion me stafin akademik, stafin drejtues dhe studentët, GVJ konstaton se programi Bachelor në “Administrim Biznesi”:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- u ofron studentëve njohuri të përparuara në fushën e “Administrim Biznesit” nëpërmjet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës manaxheriale për administratorët e kompanive private, publike apo organizatave jo fitimprurëse;</li> <li>- zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e manaxhimit, operacioneve, kontabilitetit apo financës;</li> <li>- përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018: <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ programi është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, ku çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS me një total prej 180 ECTS; studentit i ofrohen nga 10 lëndë gjatë vitit të parë dhe të dytë akademik, ndërsa në vit të tretë 11 lëndë ku janë të përfshira Praktika Mësimore si dhe Provimi Përfundimtar ose Teza e Diplomimit;</li> <li>✓ kontrolli i njohurive bëhet nëpërmjet instrumentëve të ndryshëm të vlerësimit si: frekuentimi i lëndës, detyrat e kursit, testimet gjatë vitit, provimi përfundimtar;</li> <li>✓ objektivat formues dhe kompetencat profesionale janë të përcaktuara.</li> <li>✓ kuotat e pranimit dhe grupet mësimore përcaktohen gjatë vitit akademik paraardhës;</li> <li>✓ modeli i përdorur për hartimin e Syllabuseve është bazuar në modelin e përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse,</li> </ul> </li> </ul>

	<p>emrin e Titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar; në pjesën më të madhe të lëndëve, nuk është e përcaktuar viti i botimit të literaturës bazë të detyrueshme, ose është relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41, konsideron literaturën e 5 viteve të fundit</p> <p>✓ në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë e cila shoqërohet edhe me suplementin përkatës.</p> <p>- ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive të përcaktuara nga A-E dhe me ngarkesën përkatëse në kredite; GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë të përcaktuara korrektësisht dhe se lëndët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ bazë - kategoria A, përbëjnë 17.8 % të krediteve,</li> <li>✓ karakterizuese - kategoria B, përbëjnë 54.4 % të krediteve,</li> <li>✓ integruese - kategoria C, përbëjnë 13.3% të krediteve,</li> <li>✓ plotësuese - kategoria D, përbëjnë 11% të krediteve,</li> <li>✓ detyrimeve përmblyëse - kategoria E, përmban 3.3% të krediteve.</li> </ul> <p>(Evidenca 1.6 Përcjellje e planeve mësimore) (Aneks I Tabela 10 Plani Mësimor për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”) (Aneks I Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F)) (Evidenca 2.11 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”) (Evidenca 2.13 Literatura e miratuar në Departamentin e Biznesit) (Evidenca 2.14 Strategjia e zhvillimit të programit mësimor) (Evidenca 2.5 Rregullorja e Departamentit të Biznesit) (Evidenca 2.7 Kuotat e pranimit të studentëve në programin e ciklit të parë në Administrim Biznesi) (Evidenca 3.6 Model Diplomë Bachelor në Administrim Biznesi) (Evidenca 1.5 Suplementi i Diplomës Bachelor në “Administrim Biznesi”) (Aneks I Tabela 15 Format e Kontrollit të Njohurive)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Standardi II.2</b> <b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>  <b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV), është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 105, datë 28.02.1994 me emërtim "Universiteti i Vlorës" dhe riorganizuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 822, datë 05.12.2007 dhe riemërtuar "Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë".  Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” licensuar me VKM Nr. 105, datë 28.02.1994 me afat studimi 4 vite dhe riorganizuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit, shkresë Nr. 121 Prot. Datë 22.07.2009 nga program Bachelor me kohëzgjatjete 4 vite në 3 vite.  UV është akredituar institucionalisht, sipas VBA-ASCAL, nr 71 të datës, 21.09.2017.



<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, Neni 25, pika 5, UV ka emëruar përgjegjësa për çdo program mësues të Departamentit të Biznesit si dhe respektivisht të programit Bachelor në “Administrim Biznesi”, në rolin e koordinatorit të programit të studimit, përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi një komunikim të vazhdueshëm verbal midis koordinatorit të programit dhe përgjegjës të departamentit. (Evidenca 2.3 Vendim për emërimin e Përgjegjasve të grupeve mësimore në Departamentin e Biznesit)</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FE është i organizuar në tre departamente: (1) Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit; (2) Departamenti i Biznesit; dhe (3) Departamenti i Ekonomiksit.</p> <p>Departamenti i Biznesit ofron studime në shtatë programe, tre të ciklit të parë bachelor në: (1) Administrim Biznesi; (2) Manaxhim Turizmi; (3) Marketing; dhe katër të ciklit të dytë: (1) Master Profesional në Administrim Publik; (2) Master Profesional Sipermarrje në Turizëm; (3) Master Profesional në Marketing; (4) Master Shkencor në Administrim Biznesi.</p> <p>Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin Bachelor në “Administrim Biznesi”, janë të përcaktuara në Statut, në Rregulloren e UV si dhe në Rregulloren e Departamentit, të cilat janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë.</p> <p>Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor Doktor” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit të Biznesit ka gradën shkencore, “Profesor i Asociuar”.</p> <p>FE ka në përbërje të tij për vitin akademik 2019-2020 33 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE) ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i Biznesit ka 16 anëtarë PAE, ndër të cilët 15 janë me gradë shkencore /titull akademik.</li> <li>- Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ka 10 anëtarë PAE, ndër të cilët 7 janë me gradë shkencore /titull akademik.</li> <li>- Departamenti i Ekonomiksit ka 7 anëtarë PAE, ndër të cilët 6 janë me gradë shkencore</li> </ul> <p>Përsa më sipër GVJ konstaton se të tre departamentet plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik jo vetëm për vitin akademik 2019-2020, por edhe vitet e mëparshme akademike, respektivisht 2018-2019, 2017-2018, 2016-2017.</p> <p>(Evidenca A-Statuti) (Evidenca C-Rregullore UV e Ndryshuar) (Evidenca 2.5-Rregullorja e Departamentit të Biznesit) (Aneks I, Tabela 6 Cilësia e stafit mësues për programin e studimit) (Aneks I, Tabela 1 Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë kanë informacionin e duhur (rregullorja e programit, plani mësimor, shpërndarja e lëndëve sipas pedagogëve, etj.) për organizimin e programit Bachelor në “Administrim Biznesi”, duke iu referuar, RVB, Evidencave të dorëzuara si dhe vizitës në institucion.</p> <p>(Evidenca 2.5-Rregullorja e Departamentit të Biznesit) (Aneks I Tabela 10 Plani Mësimor për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”) (Aneks I, Tabela 1 Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe konsultuar, ekspertët konstatojnë se programi Bachelor në “Administrim Biznesi” është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS secili vit; në total 180 ECTS. Studentit i ofrohen nga 10 lëndë gjatë vitit të parë dhe të dytë akademik, ndërsa në vit të tretë 11 lëndë ku janë të përfshira Praktika Mësimore si dhe Provimi Përfundimtar ose Teza e Diplomimit.</p> <p>Në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p> <p>(Aneks I, Tabela 10 Plani mësimor për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” përmban të gjithë informacionin e duhur për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.</p> <p>(Evidenca 1.4 Rregullore e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”, Neni 4,6) (Evidenca C-Rregullore e UV-së, Kreu V, neni 39,44; Kreu VI, Neni 56, 58) (Evidenca 2.6 Kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit të ciklit të parë në Departamentin e Biznesit) (Evidenca 2.7 Kuotat e pranimit të studentëve në programin e ciklit të parë Administrim Biznesi) (Evidenca 2.8 Kriteret për transferim studimesh për ciklin e parë dhe të dytë të studimit dhe procedura e transferimit të studentëve të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznesi”)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Secila lëndë e programi të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” shoqërohet me syllabusin përkatës.</p> <p>Gjatë analizës së Syllabuseve, GVJ konstatoi se modeli i përdorur për hartimin e tyre është bazuar në modelin e përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e Titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar; në pjesën më të madhe të lëndëve, nuk është e përcaktuar viti i botimit të literaturës bazë të detyrueshme, ose është</p>

	relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41, konsideron literaturën e 5 viteve të fundit ( <a href="#">Evidenca 2.11 Syllabusët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”</a> )			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton janë bërë ndryshime krahasuar me planin mësimor të liçencuar në programin Bachelor në “Administrim Biznesi” si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 17 lëndë ndryshime në ECTS (17 ECTS);</li> <li>- 1 lëndë ndryshim në Disiplinë dhe në ECTS (5 ECTS);</li> <li>- 1 lëndë me zgjedhje shtohet (5 ECTS);</li> <li>- 1 lëndë e vitit të tretë kalohet në vit të parë dhe ndryshojnë ECTS (4 ECTS);</li> <li>- Përkrah Tezës së Diplomimit shtohet mundësia e Provimit Përfundimtar (6 ECTS).</li> </ul> <p>Ndryshimi total në ECTS rezulton të jetë 37 ECTS (20%), në kufi të limitit të lejuar. Disa nga këto ndryshime rezultojnë të jenë bërë me qëllimin e përputhshmërisë me aktet nënligjore si p.sh. ndryshimi në disiplina dhe mundësia e zgjedhjes së Provimit Përfundimtar.</p> <p>GVJ sugjeron që Departamenti i Biznesit, përkrah ndryshimeve të bëra në programin mësimor të dokumentojë edhe një përmbledhje të analizës së tregut apo diskutimeve në departament. (<a href="#">Aneks I, Tabela 11 Ndryshimet në planin mësimor krahasuar me programin e liçencuar</a>) (<a href="#">Evidenca 2.12 Përcjellje e riorganizimit të programeve të studimit “Bachelor në Administrim Biznesi”</a>)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>GVJ referuar dokumentave të dorëzuar konstaton se ngarkesa e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi ku program është i organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 180 ECTS;</li> <li>- 6 semestra, 2 në çdo vit;</li> <li>- Çdo semestër zgjat 15 javë mësim dhe mesatarisht 2-4 javë provime</li> <li>- Cdo vit akademik ka 750 orë, <b>300</b> orë në auditor, <b>450</b> orë jashtë auditorit</li> <li>- Çdo vit akademik ka në total 1500 orë të shpërndara në auditor si</li> </ul>

	<p>leksione e seminare dhe studime individuale:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2"></th> <th colspan="3">Auditor</th> <th rowspan="2">Individuale</th> <th rowspan="2">Total</th> </tr> <tr> <th>Leksione</th> <th>Seminare</th> <th>Praktike</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti I</td> <td>405 orë</td> <td>225 orë</td> <td>-</td> <td>870 orë</td> <td>1500 orë</td> </tr> <tr> <td>Viti II</td> <td>420 orë</td> <td>195 orë</td> <td>-</td> <td>885 orë</td> <td>1500 orë</td> </tr> <tr> <td>Viti III</td> <td>375 orë</td> <td>135 orë</td> <td>50 orë</td> <td>940 orë</td> <td>1500 orë</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">Total</td> <td>1200 orë</td> <td>555 orë</td> <td>50 orë</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td colspan="3">1805 orë</td> <td>2695 orë</td> <td>4500 orë</td> </tr> </tbody> </table> <p>- Ngarkesa mësimore javore në auditor për leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm është deri në 25 orë/50 minuta secila (Evidenca 1.4 Rregullorja e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”) (Evidenca 2.10 Kalendar i akademik i Universitetit 2019-2020)</p>		Auditor			Individuale	Total	Leksione	Seminare	Praktike	Viti I	405 orë	225 orë	-	870 orë	1500 orë	Viti II	420 orë	195 orë	-	885 orë	1500 orë	Viti III	375 orë	135 orë	50 orë	940 orë	1500 orë	Total	1200 orë	555 orë	50 orë			1805 orë			2695 orë	4500 orë
	Auditor			Individuale	Total																																		
	Leksione	Seminare	Praktike																																				
Viti I	405 orë	225 orë	-	870 orë	1500 orë																																		
Viti II	420 orë	195 orë	-	885 orë	1500 orë																																		
Viti III	375 orë	135 orë	50 orë	940 orë	1500 orë																																		
Total	1200 orë	555 orë	50 orë																																				
	1805 orë			2695 orë	4500 orë																																		
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ është e mendimit se emërtimi i programit, përmbajtja e veprimtarive, dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë, njohuri dhe aftësi të studentëve.</p> <p>Përtej kësaj, GVJ sugjeron përfundimin e bashkëpunimit me biznesin dhe zgjerimin e këtyre bashkëpunimeve për të mundësuar praktika dhe punësim sa më efektiv të studentëve.</p>																																						
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ është i mendimit se shpërndarja në vite e semestra i lëndëve/moduleve, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor.</p> <p>Gjithsesi GVJ sugjeron që Departamenti i Biznesit të përafrojë programin e studimit me programe të ngjashme ndërkombëtare, për të mundësuar punësimin dhe mobilitetin e studentëve në vendet e Bashkimit Europian.</p> <p>(Aneks I, Tabela 10 Plani mësimor për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”) (Evidenca 2.11 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)</p>																																						
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë analizës së Syllabuseve, GVJ konstatoi se në pjesën më të madhe të lëndëve, nuk është e përcaktuar viti i botimit të literaturës bazë të detyrueshme dhe ndihmëse, ose është relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41, konsideron literaturën e 5 viteve të fundit (Evidenca 2.11 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)</p>																																						
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të</p>	<p>GVJ konstatoi se përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë dhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në tregun e punës.</p> <p>(Aneks I, Tabela 10 Plani mësimor për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)</p>																																						

studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.									
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, UV në dhjetor të vitit 2019 ka organizuar Ëorkshop-i me temë “Studentët dhe tregu i punës”. Ky ëorkshop është organizuar në rang institucioni, dhe GVJ sugjeron shtrirjen e këtyre bashkëpunimeve konsultative me bashkëpunëtorë dhe partnerë në rang Fakulteti dhe Departamenti për të patur një kontribut efektiv. <a href="https://univlor.edu.al/2019/12/22/ëorkshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/">https://univlor.edu.al/2019/12/22/ëorkshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/</a>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>			X	
<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
		X							

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Në programin Bachelor në “Administrim Biznesi” për realizimin e këtij programi gjatë vitit akademik 2019-2020 janë të angazhuar 27 pedagogë si PAE dhe 1 personel akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Për sa i përket kualifikimeve të PAE:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 pedagog mban gradën Prof. Dr.</li> <li>- 5 pedagogë mbajnë gradën Prof. Assoc. Dr.</li> <li>- 14 pedagogë mbajnë gradën Dr.</li> <li>- 7 pedagogë kanë kualifikimin MSc.</li> </ul> <p>Referuar Statutit të UV-së, Kreu V, Neni 45, pika 7, anëtarët e personelit akademik të kategorisë “Asistent Lektorë”, punësohen në UV me një kontratë me kohëzgjatje të caktuar.</p> <p>GVJ konstaton se personeli akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar (Msc) është në proces doktorature.</p> <p>Referuar dokumentacionit të konsultuar më sipër si dhe CV-ve të stafit akademik dhe programit mësimor, GVJ konstaton se për të tre vitet akademike 2016-2017, 2017-2018, 2019-2020, programi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përmbush kërkesën ligjore për stafin akademik që të jetë të paktën 70 % të jenë staf efektiv (VKM 418, Maj 2017).</li> <li>- përmbush kërkesën ligjore e të pasurit së paku kualifikimin e një cikli pasardhës për të gjithë stafi akademik që mbulon programin akademik;</li> <li>- niveli i kualifikimit, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe</li> </ul>

	<p>specifike e anëtarëve të personelit akademik janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> <p>(Aneks I, Tabela 6 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit) (Evidenca A-Statuti i UV) (Aneks I Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës) (Evidenca 2.16 CV-të e personelit akademik pranë Departamentit të Biznesit) (Evidenca 2.11 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Biznesit ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas si dhe institucione publike në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, por rekomandon që të shtohet larmishmërinë dhe numrin bizneseve, pasi një pjesë rezulton të jenë furrë buke, market e kafene, për të mundësuar si zhvillimin e praktika sa më efektiv ashtu dhe një punësim të mundshëm të studentëve pas diplomimit.</p> <p>Departamenti i Biznesit vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale si dhe punimin e diplomës.</p> <p>(Aneksi I Tabela 5 Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë) (Evidenca 1.6 Procedura e praktikës) (Evidencë Shtesë Nr. 7 Nje praktike te plote (detyra) te studentit qe dorezon ne fund te praktikës profesionale.pdf)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Laboratori informatik është vënë nga institucioni në funksion të studentëve të programit Bachelor në «Administrim Biznesi» për të mundësuar formimin praktik të tyre. Në këto lëndë (Sistemet e informacionit në ekonomi; Teknologji informacioni dhe komunikimi në ekonomi; Kontabiliteti) që zhvillohen pjesërisht në laborator, studentët krahas pedagogut të lëndës asistohen edhe nga stafi ndihmës akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli ndihmës mësimor shkencor është i angazhuar për realizimin e orëve mësimore, mirëmbajtjen e laboratorëve, funksionimin e bibliotekës etj.</p> <p>(Aneks I Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p><b>Standardi III.1</b>  <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>
--

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve apo moduleve.</p> <p>Gjithashtu, në Planin Strategjik Institucional 2018-2024, fq. 31, bën pjesë skenari i zhvillimit të Universitetit Smart, i cili do të fokusohet në shfrytëzimin me efektivitet të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit në sistemin e menaxhimit dhe organizimit institucional.</p> <p>(Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.pdf) (Evidenca B-Plani Strategjik 2018-2024.pdf)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe takimeve me drejtuesit e njësisë, stafit dhe Njësisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVI) gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatojnë si mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse të stafit akademik në programin Bachelor në “Administrim Biznesi”:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Implementimin e “Pyetësorit të Vlerësimit të Cilësisë së Mësimdhënies së Lëndës” nga ana e studentëve në fund të çdo semestri, rezultatet e të cilit përpunohen nga NJSBCVI dhe analizohen në FE dhe Departamentin e Biznesit.</li> <li>- Raportimit Vjetor të Departamentit lidhur me ngarkesën mësimore të stafit dhe performancës në kërkimin shkencor.</li> </ul> <p>(Evidenca 1.9 Raporti Vjetor i Departamentit të Biznesit, 2018-2019) (Evidenca K- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018.pdf) (Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019.pdf) (Evidenca 3.1 Vendim i Senatit Akademik UV, Nr. 84, Dt. 12.12.2016) (Evidenca 1.7 Vendim i Senatit Akademik UV, Nr. 8, Dt. 14.02.2018)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin semestral të formave dhe metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet “Pyetësorit të Vlerësimit të Cilësisë së Mësimdhënies së Lëndës”.</p> <p>Gjithashtu institucioni nëpërmjet rregullore së tij, u garanton studentëve të drejtën e ankimit për rezultatet e vlerësimit të dijeve. Institucioni u ka vënë gjithashtu në dispozicion si studentëve ashtu edhe stafit akademik një adresë të posaçme elektronike për adresimin e ankimeve dhe shqetësimeve.</p> <p>(Evidenca C-Rregullore e UV-së, Kreu VII, Neni 62) (Evidenca 3.2 Vendimi i Senatit Akademik UV, nr. 94, Dt. 13.10.2017 “Për një adresë të posaçme elektronike për adresimin e ankimeve dhe shqetësimeve të studentëve dhe stafit akademik”)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se NJSBCVI përcjell zyrtarisht pranë çdo njësie bazë rezultatet e vlerësimit të studentëve për çdo pedagog duke u mundësuar atyre njohjen me vlerësimet përkatëse.</p> <p>NJSBCVI bën publike në Website të UV-së një agregim të rezultateve të vlerësimit të studentëve në rang institucional dhe fakulteti.</p>

	<a href="https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Analiza-e-pyetesoreve-Hyrje-.pdf">https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Analiza-e-pyetesoreve-Hyrje-.pdf</a> <a href="https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Fakulteti-Ekonomik-Raport-i-Analizes-se-Pyetesoreve-te-Studenteve.pdf">https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Fakulteti-Ekonomik-Raport-i-Analizes-se-Pyetesoreve-te-Studenteve.pdf</a>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Në RVB si dhe gjatë vizitës në institucion është raportuar që Departamenti i Biznesit në analizën vjetore të punës përfshin edhe analizën e cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>GVJ konstaton se në Raportin Vjetor të Departamentit të Biznesit për vitin akademik 2018-2019, lidhur me analizën e cilësisë në mësimdhënie janë raportuar vetëm statistika të mesatare të studentëve për çdo lëndë si dhe përqindjes së kalueshmërisë së tyre.</p> <p>Për sa më sipër, GVJ sugjeron që përtej analizave sasiore, departamenti të fokusohet edhe në analiza cilësore si dhe shkëmbimin e eksperiencave midis stafit apo hulumtimit me fokus përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie. (Evidenca 1.9 Raporti Vjetor i Departamentit të Biznesit, 2018-2019)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.2</b> <b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible</p>	<p>GVJ konstaton nëpërmjet planit mësimor të programit Bachelor të “Administrim Biznesi” si dhe takimeve me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion, se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive të përdora janë leksione/seminare/ detyra grupi/detyra kursi.</p> <p>Në planin mësimor, në total rezultojnë orë mësimore në auditor:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione                               <b>1200</b> orë mësimore</li> <li>- Seminare                               <b>555</b> orë mësimore</li> <li>- Praktika profesionale <b>50</b> orë praktikë në terren</li> <li>- Gjithsej në auditor   <b>1805</b> orë mësimore</li> </ul> <p>Ndërkohë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Punimi i diplomës/Provimi prërfundimtar <b>150</b> orë studim individual</li> </ul> <p>Në planin mësimor të programit praktika është paraqitur si orë studimi individuale, fq. 85 e RVB. GVJ e konsideron praktikë në auditor <b>për studentin</b> (pavarësisht se për stafin ajo konsiderohet si punë në terren)</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rishtazi një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të</p>



<p>pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>ndryshme inovative të mësimdhënies ku fokusi është në implementimin e modelit “Studenti në Qendër” nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rast studimi,</li> <li>- mësim në grup,</li> <li>- bord diskutimi</li> <li>- studim individual literature</li> <li>- të mësuarit në bazë problemi</li> <li>- simulimi i situatave</li> <li>- përdorimi i mjeteve multimedia</li> <li>- qendrat e mësimit, etj.</li> </ul> <p>(Aneks I Tabela 10 Plani mësimor)</p> <p>(Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.pdf)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Referuar programit mësimor, CV-ve të stafit akademik, Syllabuseve, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit</p> <p>(Aneks I, Tabela 6 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit) (Aneks I Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës) (Evidenca 2.16 CV-të e personelit akademik pranë Departamentit të Biznesit) (Evidenca 2.11 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rishtazi një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies ku fokusi është në implementimin e modelit “Studenti në Qendër”.</p> <p>Gjithashtu gjatë vizitës në institucion dhe takimeve të zhvilluara me stafin mësimdhënës dhe studentët, GVJ konstaton se personeli akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor metoda interaktive dhe diskutimi, për ta bërë sa më tërheqëse orën e mësimit;</li> <li>- vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies, duke reflektuar mendimet e sugjerimet e studentëve të paraqitura në vlerësimet periodike të studentëve;</li> <li>- nëpërmjet metodave të mësimdhënies mundohen të inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</li> </ul> <p>(Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.pdf)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>



**Standardi III.3**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga njësia bazë si dhe inspektimit të ambienteve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- FE ka vënë në dispozicion të programit Bachelor në “Administrim Biznesi” 19 salla në godinën A për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, si dhe një laborator,</li> <li>- hapësirat janë të mjaftueshme, me ndriçim dhe ajrosjen e duhur dhe mirëmbahen e pastrohen nga stafi ndihmës i fakultetit,</li> <li>- janë funksionale dhe çdo pedagog është i pajisur me videoprojektor nga institucioni për përdorim në sallën e mësimin,</li> <li>- studentët dhe pedagogët janë të pajisur me një adresë postare nga institucioni e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas,</li> <li>- kanë përdorim platformën dixhitale “Sistemi i Menazhimit të Informacionit Mësimor (UVMS) të UV-së”.</li> <li>- Në dispozicion të secilës Njësi Kryesore është një personel i Strukturës së Teknologjisë së Informacionit</li> <li>- Por gjatë takimit me studentët ato kërkuan:             <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngrohjen e ambienteve gjatë dimrit;</li> <li>2. Ndërrimin e dërrasave të zeza me të “ëhiteboard” pasi dërrasat ekzistuese nuk ishin funksionale.</li> <li>3. Montimin e projektorëve në klasa, duke qenë se instalimi i tyre para çdo ore mësimore merr kohë.</li> </ol> </li> </ul> <p>(Evidenca 2.9 Kapacitetet akademike dhe fizike të FE-së)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë analizës së Syllabuseve, GVJ konstatoi se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit, por në pjesën më të madhe të lëndëve, nuk është e përcaktuar viti i botimit të literaturës bazë të detyrueshme dhe ndihmëse, ose është relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41, konsideron literaturën e 5 viteve të fundit; (Evidenca 2.11 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi hapësirat e bibliotekës së institucionit janë të vogla dhe të pamjaftueshme duke konsideruar numrin e studentëve që studiojnë në institucion. Gjithashtu biblioteka ka një numër tepër të kufizuar të botimeve lidhur me fushën e studimit të programit jo vetëm në literaturën e huaj por edhe atë shqipe.</p> <p>Megjithëse Senati ka marrë një vendim “Për miratimin në parim të regjistrimit të UV-së në një bibliotekë online” në korrik të vitit 2017, kjo ende nuk është efektive.</p>

	(Evidenca 3.4 Vendimi Senati Nr. 83. Dt. 18.07.2017 “Për miratimin në parim të regjistrimit të UV-së në një bibliotekë online”)			
	(Evidenca 4.3 Relacion me informacionin mbi Bibliotekën shkencore Godina A, në funksion të akreditimit të programeve të studimit)			
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë bibliotekën online nëpërmjet Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH).			
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. <b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. <b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Institucioni ka vënë në dispozicion të FE-së një laborator informatike, i cili shfrytëzohet nga studentët e programit për një pjesë të lëndëve duke përdorur programe specifike në varësi të lëndës. Gjithashtu në dispozicion të studentëve, megjithëse me hapësira të limituara, janë vënë edhe ambientet e bibliotekës në Godinën A, e cila përdoret për punimin e detyrave të kursit, temës së diplomës apo studimeve specifike. GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimit me stafin akademik dhe studentët konstatoi se studentët dhe pedagogët janë të pajisur me një adresë postare nga institucioni e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas. Nëpërmjet përdorimit të platformës dizhitale UVMS, pedagogu i lëndës ka mundësinë të ngarkojë në sistem materialet mësimore si leksione, prezantime, detyra dhe komunikime të tjera. Në Planin Strategjik të Departamentit të Biznesit 2018-2024, është parashikuar zhvillimi i mëtejshëm i sistemit ICT dhe i infrastrukturës në ndihmë të mësimdhënies.  (Evidenca 2.9 Kapacitetet akademike dhe fizike të FE-së) (Evidenca 1.3 Plani Strategjik i Departamentit të Biznesit 2018-2024)			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	GVJ konstaton se në Rregulloren e Programit të Ciklit të parë të Studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”, Neni 3, është e përcaktuar se personeli akademik i caktuar për udhëheqjen e studentëve në punimin e tezës së diplomës, orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave si dhe i asiston dhe i mbështet.  (Evidenca 1.4 Rregullore e Programit të Ciklit të parë të Studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional	NJSBCVI ka funksion kryesor sigurimin e cilësisë së brendshme të

<p>që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>institucionit në përputhje me Kodin e Cilësisë. Kjo njësi realizon vlerësime periodike për veprimtaritë mësimore, pyetësorët e studentëve, perpunimin dhe analizën e tyre, si dhe vlerësime për veprimtaritë kërkimore shkencore dhe harton raportimin në nivel institucional.</p> <p>Njësi të tjera ndihmës-akademike me karakter administrative në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qendra studimore ndërdisiplinore e zhvillimit rajonal,</li> <li>- Sektori i kurrikulave dhe shërbimit ndaj studentëve,</li> <li>- Sektori i këshillimit të karrierës,</li> <li>- Sektori i komunikimit dhe marrëdhëniet me jashtë</li> </ul> <p>(Evidenca K- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2017-2018.pdf) (Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2018-2019.pdf)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimit të mëtejshëm të stafit akademik dhe studentët në programin Bachelor në “Administrim Biznesi” janë zv. Dekani për anën akademike, Drejtuesi i Departamentit si dhe Drejtuesi i Grupit Mësimor.</p> <p>Një ndër mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse të stafit akademik në program është plotësimi i “Pyetësorit të Vlerësimit të Cilësisë së Mësimdhënies së Lëndës” nga ana e studentëve në fund të çdo semestri, rezultatet e të cilit përpunohen nga NJBSC dhe së bashku me rekomandimet e njësisë analizohen dhe konsultohen më gjerë në Departamentin e Biznesit me stafin mësimdhënës. Në fund të vitit akademik departamenti përgatit një raport vjetor.</p> <p>Departamenti gjithashtu ka ndjekur praktikën e përfitimit të eksperiencës në mësimdhënie nga pedagogë të ftuar të përfshirë në mësimdhënien e lëndëve të caktuara duke pasur si qëllim edhe rritjen e vetëdijes së personelit akademik si dhe studentëve për cilësinë në mësimdhënie.</p> <p>Gjatë periudhës Mars-Korrik 2019, si dhe Dhjetor 2019 e në vazhdim, në NJBSC janë përfshirë edhe studentë të cilët janë angazhuar në fushata informuese dhe promovuese për Plotësimin e Pyetësorit të Studentëve për Vlerësimin e Cilësisë në Mësimdhënie, Sondazhit Kombëtar rre Studentëve, si dhe në grupe të ndryshme të ngritura me qëllim përpilimin ose rishikimin e instrumentave të vlerësimit të brendshëm.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rishtazi një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies ku fokusi është në implementimin e modelit “Studenti në Qendër” nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rast studimi,</li> <li>- mësim në grup,</li> <li>- bord diskutimi</li> <li>- studim individual literature</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të mësuarit në bazë problemi</li> <li>- simulimi i situatave</li> <li>- përdorimi i mjeteve multimedia</li> <li>- qendrat e mësimit, etj.</li> </ul> <p>(Evidenca 1.9 Raporti Vjetor i Departamentit të Biznesit, 2018-2019) (Aneksi I Tabela 24 Të dhëna për anëtarët e NJBSC) (Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.pdf)</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Referuar takimit në institucion me drejtuesit e Fakultetit, Departamentit si dhe stafin, rezultoi që UV alokon një buxhet vjetor për mbulimin e shpenzimeve të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca, ëorkshope si dhe botime të artikujve në revista shkencore. Arritjet në kërkimin shkencor të stafit të Departamentit janë pjesë e raportit vjetor.</p> <p>Institucioni gjithashtu mbështet pjesëmarrjen e stafit në projektet kërkimore dhe mobilitet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p>Megjithatë GVJ është e mendimit se njësi bazë duhet të iniciojë procese për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.</p> <p>(Evidenca 1.9 Raporti Vjetor i Departamentit të Biznesit, 2018-2019 (Evidenca J-Raporti Vjetor i UV-së për vitin 2018-2019, fq. 87-95) (Evidenca F-Rregullore e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV) (Evidenca G-Strategjia për Trajnimin e vazhdueshëm të Kërkuesve të rinj)</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Referuar takimeve të zhvilluara në institucion si me drejtuesit ashtu dhe me stafin, GVJ konkludon se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p>Gjithsesi GVJ është e mendimit se përtej udhëzuesit për zhvillimin dhe përdorimin e metodave novatore në mësimdhënie, njësi bazë duhet të iniciojë procese të trajnimeve të ndryshme për implementimin e këtyre metodave të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> <p>(Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.pdf)</p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> <td></td> </tr> </table>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>			<b>X</b>	
<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
		<b>X</b>							

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen	Referuar dokumentacionit të aksesuar, GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive, përcaktohen si në rregulloren institucionale e cila është edhe publike në

në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	ëebsite të UV, ashtu edhe në rregulloren e Departamentit dhe të programit specifik si dhe njihen nga studentët.  (Evidenca C-Rregullore e UV-së) (Evidenca 1.3 Rregullore e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në “Administrim Biznes”) (Rregullore e Departamentit të Biznesit) ( <a href="https://univlora.edu.al/rregullorja/">https://univlora.edu.al/rregullorja/</a> )								
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.  <b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik konstatoi se studentët informohen nga stafi akademik në fillim të semestrit për, programin e lëndës, format alternative të vlerësimit, dhe detyrimet që ata kanë dhe që janë të parashikuara në Syllabuse.  Referuar syllabuseve të lëndëve të programit, GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme të ndërthura (me shkrim; me gojë; detyra kursi; projekte) të përcaktuara nga titullari i lëndës, për ti dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. (Evidenca 2.11 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	GVJ referuar burimeve alternative, syllabuseve, rregulloreve e stafit akademik konkludon se vlerësimi është gjithë semestral, me komponente të tillë si detyra individuale, detyra kursi, mid term dhe provimi final, komponentët e të cilëve reflektohen në vlerësimin final.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UV ka në përdorim një platformë elektronike interaktive në funksion të studentëve, stafit akademik dhe administrativ, por kjo platformë ende nuk mundëson testimin dhe vlerësimin elektronik të studentëve, me qëllim rritjen e transparencës.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Referuar Rregullores së Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.  (Evidenca 1.3 Rregullore e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.  <b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet	Referuar vizitës në institucion dhe dokumentave të aksesuar, GVJ konstaton se testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, nuk zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim.  Rregullorja institucional parashikon procedura strikte lidhur me afatet e editimit të rezultateve të provimit në sistemin UVMS, jo më vonë se 48 orë nga dita e zhvillimit.  Një ditë pas zhvillimit të provimit, studentëve u jepet e drejta të

<p>me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>shikojnë personalisht provimin për të marrë sqarimet e duhura mbi tezën e korigjuar nga pedagogu si dhe të paraqesin ankesat e tyre në lidhje me saktësinë e korigjimit dhe vlerësimit nga ana e pedagogut. Ankesa i paraqitet me shkrim Drejtuesit të Departamentit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni dekanin. Dekani brenda 48 orësh nga marrja e ankesës, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e ankimit të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit dhe ndryshimet në rezultatet e studentit pasqyrohen në procesverbalin e firmosur nga komisioni, rezultat i cili pasqyrohet edhe në sistemin elektronik.</p> <p>Provimet zhvillohen me mbikëqyrje nga komisioni për të shmangur kopjimin, ndërkohë për plagjiaturën ende nuk ka një program softëare për evidentimin e saj në detyrat e kursit apo punimet e tezave.</p> <p>GVJ rekomandon që institucioni të investojë në sigurimin e një programi antiplagjaturë.</p> <p>(Evidenca C-Rregullore e UV-së)</p> <p>(Evidenca 1.3 Rregullore e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
<p><b>X</b></p>				

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Referuar informacionit të siguruar nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezulton se metodat e përdorura, janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve; në leksione dhe seminare, synohet aktivizimi i studentëve, nëpërmjet rasteve studimore, detyrave të grupit, detyrave të kursit, për të zhvilluar aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p>Nëpërmjet lëndëve si Teknologji informacioni dhe komunikimi në ekonomi; E drejtë biznesi; Komunikim në botën e biznesit; Gjuhë e huaj për Fakultetin Ekonomik, programi i studimit synon të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve, në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimi dhe ndërveprimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga takimi me pedagogët, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen dhe shqyrtohen si në fillim ashtu dhe në përfundim të çdo lënde.</p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Gjithashtu në seancën e fundit të semestrit cdo pedagog realizon një përmbledhje të lëndës, temave kryesore dhe orienton studentët rreth testit përfundimtar, dhe adreson paqartësitë që studentët kanë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në RVB paraqitet se Departamenti i Biznesit nëpërmjet profesorëve të ftuar nga universitetet brenda vendit janë trajtuar informacionet e përditësuara lidhur me lëndët për të cilat janë ftuar.</p> <p>GVJ sugjeron që institucioni të inkurajojë personelin akademik efektiv në realizimin e orëve të hapura dhe seminareve mbi zhvillimet të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit dhe jo vetëm nëpërmjet akademikëve të ftuar në leksione.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Referuar planit mësimor, syllabuseve, CV-ve të stafit mësimdhënës si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, GVJ konstaton se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim i njohurive të siguruar nga teoria.</p> <p>Personeli akademik inkurajon studentët të përfshihen në aktivitete dhe detyra grupi për adresimin e sfidave dhe problemeve të biznesit, nëpërmjet rasteve studimore të situatave komplekse të biznesit apo projekteve analitike. Stafi akademik mundohet të ofrojë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve, të cilat gjejnë edhe mbështetjen institucionale. Kërkimet më të vlerësuara të studentëve të studentëve të vitit të tretë prezantohen dhe mbështeten në konferencat e organizuara nga institucioni.</p> <p>(Evidenca G-Strategjia për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj)</p> <p><a href="https://univlora.edu.al/2019/10/09/8th-asecu-youth-international-conference-and-summer-school/">https://univlora.edu.al/2019/10/09/8th-asecu-youth-international-conference-and-summer-school/</a> <a href="https://univlora.edu.al/en/2018/10/29/1st-international-conference-on-marketing-and-tourism-2018-icmt-2018/">https://univlora.edu.al/en/2018/10/29/1st-international-conference-on-marketing-and-tourism-2018-icmt-2018/</a></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Me fokus mundësimin e mobilitetit edhe të studentëve të programit Bachelor në “Administrim Biznesi”, për të cilën nuk është realizuar asnjë mobilitet, stafi akademik i departamentit është duke shqyrtuar oportunitetet e ndërthurrjes së formave të mësimdhënies me institucionet partnere.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.8</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose</p>	<p>Referuar rregullores së programit Bachelor në “Administrim Biznesi”, neni 14-15, organizohet provimi final ose mbrojtja e diplomës para</p>



<p>mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>diplomimit të studentëve. Kjo rregullore bëhet publike gjatë takimeve informuese me studentët në përfundim të semestrit të parë për studentët e vitit të fundit nga drejtuesit e departamentit dhe sekretares mësimore.</p> <p>Studentëve u vihen në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës nga sekretaria mësimore, pedagogu udhëheqës i temës së diplomës, si dhe pedagogët të cilët kanë hartuar bankën e pyetjeve.</p> <p>Programi i provimit final bazohet në njohuritë e marra gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë dhe miratohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit. Studentët mund të tërheqin bankën e pyetjeve pranë sekretarisë mësimore të departamentit.</p> <p>Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit dhe përcakton grafikun e konsultimeve për konsultat dhe kontrollet e punës së bërë nga studenti. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur.</p> <p>Studentëve të cilët punojnë temën e diplomës, u vihet në dispozicion baza e të dhënave e institucioneve me të cilat FE bashkëpunon për realizimin e praktikave studentore.</p> <p>Si provimi final ashtu edhe mbrojtja e diplomës zhvillohen me gojë studentit vlerësohet me notë. Rezultatet e provimit final u shpallen studentëve në fund të çdo dite provimi nga komisioni i provimit. Për studentët të cilët mbrojnë diplomën, ato vlerësohen nga çdo anëtar i komisionit, dhe si vlerësim final merret mesatarja aritmetike e të pesë anëtarëve.</p> <p><a href="#">(Evidenca 1.3 Rregullore e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”)</a></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar, GVJ konkludon se institucioni pajis me diplomë, listë notash dhe suplement diplome të miratuara nga MASR çdo student i cili ka plotësuar detyrimet e programit Bachelor në “Administrim Biznesi” dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material. Suplementi i diplomës është i hartuar në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë.</p> <p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar pas depozitimit të një kërkesë nga studenti pranë sekretarisë.</p> <p>Sekretaria mësimore e FE ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit në formë të shkruar dhe elektronike. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bëhet prej sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri.</p> <p><a href="#">(Evidenca 3.6 Model Diplomë Bachelor Administrim Biznesi)</a> <a href="#">(Evidenca 1.5</a></p>

	Suplementi i Diplomës Bachelor në “Administrim Biznesi” (Evidenca C-Rregullore e UV)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga konsultimi i dokumentacionit të depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, rezulton se Zyra e burimeve njerëzore ruan të dhëna të plota për stafin akademik si dhe atë ndihmësimor-shkencor dhe administrative të cilët janë të angazhuar në çdo vit akademik dhe çdo semestër në programin e studimit “Administrim Biznesi”, niveli Bachelor.  Këto të dhëna, përmbajnë emrat e stafit akademik, lëndët për çdo semestër, orët mësimore dhe ngarkesën totale.  <i>(Tabela 6.2, 6.3, 6.4 RVB) (Evidenca 4.1.PDF)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Referuar RVB, Dokumentacionit në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe vizitës në UV, rezulton se procedurat e rekrutimit janë zhvilluar në përputhje me Statutin e UV, neni 51 dhe Rregullores së UV, nenet 27 dhe 28.  Rezulton se ka një koordinim mes njësisë bazë përgjegjëse për këtë program si dhe zyrës së Burimeve Njerëzore në nivel institucioni, me përgjegjësi të ndara dhe në përputhje me bazën ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore.  <i>(Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Referuar procedurës së rekrutimit marrë gjatë vizitës në institucion (ref. në sistemin e ASCAL) si dhe asaj të konsultuar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Institucioni harton kërkesa të përgjithshme, kriteret bazë si dhe kriteret preferenciale për stafin e programit.  Referuar uebit të UV, rezulton se institucioni publikon në faqen e internetit, thirrjet për punësim të stafit akademik efektiv dhe atyre me

	<p>kohë të pjesshme.</p> <p>Në këtë thirrje rezulton e publikuar edhe procedura si dhe metodologjia e vlerësimit nga komisioni ad hoc.</p> <p>GVJ rekomandon publikimin e thirrjeve për punësim edhe në burime të tjera alternative siç është faqja e APP, apo media vizive dhe e shkruar duke i shërbyer kështu shpërndarjes së informacionit në shkallë më të gjerë, duke rritur visibilitetin e thirrjes për të rritur numrin e aplikantëve cilësorë, referuar kjo edhe dy procedurave të konsultuara, ku në njërin prej tyre për 1 vend vakant si staf me kohë të pjesshme ka aplikuar vetëm 1 kandidat, dhe në atë për staf me kontratë kanë aplikuar 2 kandidatë.</p> <p><i>(Evidenca 4.2.pdf) (<a href="https://univlora.edu.al/2019/10/28/universiteti-ismail-qemali-vlore-shpall-njoftimin-er-vendin-e-lire-te-punes-Inje-personel-akademik-me-kohe-te-pjesshme-per-vitin-akademik-2019-2020-prane-departamentit-te-ekono/">https://univlora.edu.al/2019/10/28/universiteti-ismail-qemali-vlore-shpall-njoftimin-er-vendin-e-lire-te-punes-Inje-personel-akademik-me-kohe-te-pjesshme-per-vitin-akademik-2019-2020-prane-departamentit-te-ekono/</a>)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni i depozituar nga institucioni, në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe nga vizita në institucion nuk konsultoi praktikë rekrutimi të stafit akademik të PS BA në Administrim Biznesi. Praktikantët e konsultuara ishin për staf akademik jashtë programit për të cilin bëhet ky akreditim. Mbështetur në procedurën e konsultuar gjatë vizitës në institucion si dhe asaj që është pjesë e DVV (dosjes së vetëvlerësimit) për staf akademik jashtë programit të studimit, GVJ konstaton se procedura e rekrutimit si dhe vlerësimi mbështeten në kriteret e publikuara dhe në metodologjinë e vlerësimit të publikuar në thirrjen për punësim. <i>(Evidenca 4.2.pdf DVV, Praktika e plote e konkursit të SB, VI)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi IV.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se UV ka siguruar investime të cilat ofrojnë mjedise dhe zyre me kushte të pranueshme për stafin akademik dhe atë joakademik.</p> <p><i>(Evidenca 69 Infrastruktura.PDF)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton në planin strategjik të institucionit si prioritet zhvillimin e profesional dhe akademik të stafit. Referuar takimeve me GVB, me stafin e programit si dhe drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se institucioni mbështet stafin akademik duke suportuar pagesat e rregjistrimeve në konferenca shkencore ku ata marrin pjesë.</p> <p>Kjo është një praktikë e vlerësueshme motivuese, por referuar evidencës ku vihet re se kanë përfituar një numër i limituar stafi akademik, GVJ sugjeron një qasje më proaktive nga ana e institucionit, në formatin e një politike motivuese e sanksionuar për gjithë stafin akademik, e planifikuar</p>

	<p>në buxhetin vjetor e cila do të nxiste një përfshirje më të gjerë të stafit akademik të programit në aktivitete shkencore dhe që do të shërbente edhe si bazë për vlerësimin e performanceës së stafit.</p> <p>Gjithashtu në kudër të programit Erasmus +, UV ka marrëveshjeve të përbshkëta me universitete të huaja, të cilat krijojnë mundësi për stafin akademik të krijojnë eksperiencë mësimdhënieje në këto universitete dhe të mund të përfitojnë profesionalisht prej këtyre eksperiencave, por këto deri tani rezultojnë si potenciale për të ardhmen. Duke iu referuar të dhënave të siguruar, rezultojnë që gjatë 2018-2019 të ketë përfituar një pedagog i fakultetit të Ekonomisë (<i>Vizita ne institucion, Evidenca 6. Nje praktike reale e mbështetjes buxhetore te pedagogeve per kerkim shkencor.PDF Evidenca 2.Lista e botimeve dhe konferencave te sponsorizuar nga Universiteti ne tre vitet e fundit</i>). (<i>Lista e projekteve ku UV është lider-partner.pdf; VI; <a href="https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/statistika/">https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/statistika/</a></i>)</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Referuar RVB si dhe takimeve me drejtues dhe me stafin e programit, GVJ nuk konstatoi iniciativa të institucionit apo organizime të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor ku stafi akademik i këtij programi të ketë marrë pjesë. Në takimin me stafin akademik, rezultoi vetëm një rast i trajnimit i zhvilluar individualisht. Pavarësisht kësaj situate, GVJ referuar dokumentacionit në sistem vlerëson pozitivisht iniciativën e institucionit dhe miratimin e udhëzuesit në nivel institucional, implementimi i të cilit në të ardhmen do të ketë efekte pozitive në metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e tyre. (<i>Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Referuar strukture organizative të institucionit, stafit akademik dhe joakademik të përfshirë në programin Bch në Administrim Biznesi, informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, rezultojnë se UV vë në dispozicion të PS Bsc në “Administrim Biznesi” staf të angazhuar dhe optimizim përdorimin e burimeve njerëzore për realizimin e objektivave të këtij PS.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi IV.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe</p>	<p>GVJ referuar DVV dhe evidencave të siguruar për kapacitet infrastrukturale të UV në dispozicion të PS Ba në Administrim Biznesi si dhe vizitës në institucion, është i mendimit se UV siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike e ndikuar kjo edhe nga investimet e bëra për përmirësimin e kushteve fizike të sallave të</p>



moduleve përkatëse.	leksioneve/seminareve dhe jo vetëm, por edhe nga zvogëlimi i numrit të studentëve të rregjistruar, duke krijuar më tepër mundësi për ata që kanë zgjidhur këtë program studimi. Gjithashtu zhvillimi i mësimin në hapësira të përputhje me numrin e studentëve favorizohet edhe nga zhvillimi i procesit mësimor në dy fasha orare, edhe pse studentët e PS në Bsc “Administrim Biznesi” e zhvillojnë procesin mësimor në orarin 8.00-14.00 (Evidenca 69. <a href="#">Infrastruktura.PDF</a> )			
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se në dispozicion të studentëve të PS në Ba Administrim Biznesi është një laborator informatike me kapacitet 25 poste, I pajisur me PC, Skaner, Videoprojektor si dhe softje profesionale për zhvillimin e lëndëve specifike. Ky program është në dispozicion të studentëve të PS, në lëndët e informatikës, statistikës apo për lëndët e kontabilitetit dhe financës së informatizuar.</p> <p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor të PS BA në AB, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme, poste ulje, tavolina, pod lekturimi, ëhite bord.</p> <p>Në klasa nuk u konstatuan videoprojektore, kompjutera apo pajisje të tjera të teknologjisë së informacionit, por nga takimet me studentë rezultoi se sipas disiplinave të ndryshme, profesorët mund t’i kenë mjetet audiovizive portable.</p> <p>Institucioni duhet të realizojë edhe mbulimin e vazhdueshëm me internet të këtyre hapësirave, si domosdoshmëri për përdorimin e teknologjive të informacionit si dhe metodave alternative të mësimdhënies.</p> <p>(Evidenca 69. <a href="#">Infrastruktura.PDF</a>)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Nga takimi me drejtues të të njësisë kryesore dhe asaj baëzë përgjegjëse për PS në Administrim Biznesi si dhe nga Evidencat e siguruar, praktikantët e studentëve të PS, e zhvillojnë praktikën pranë institucioneve dhe kompanive me të cilat UV ka marrëveshje të cilat disponojnë kapacitetet pritëse infrastrukturale të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e praktikave të tyre.</p> <p>(Aneksi 1, Tabela 5 RVB)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën</p>	<p>UV vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore. Kjo</p>

<p>mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>bibliotekë rezulton biblioteka qendrore e institucionit dhe është në shërbim për studentët e disa njësive kryesore. Referuar evidencave për infrastrukturën e UV, sipërfaqja e saj është 250 m<sup>2</sup> me 60 poste dhe 9 PC.</p> <p>GVJ rekomandon zgjerim të hapësirës së bibliotekës dhe përmirësim të kushteve të saj infrastrukturale, numer fizik postesh, vendosje te me shumë PC, për të qenë një mjedis më funksional dhe për të siguruar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e PS bch në Administrim Biznesi, duke qenë se kjo bibliotekë është biblioteka qendrore e institucionit dhe është në shërbim të studentëve dhe stafit akademik të shumë programeve studimi bachelor dhe master, edhe të njësive të tjera kryesore.</p> <p><a href="#">Evidenca 4.3.PDF</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ referuar evidencës 4.3 të DVV, vlerëson iniciativat e institucionit për pasurim të vazhdueshëm të bibliotekës. Pavarësisht kësaj, gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një fond të limituar librash fizike, periodike, revista në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën ekonomisë.</p> <p>Pavarësisht këtij fondi ekzistues, GVJ rekomandon se UV duhet të zgjerojë fondin e bibliotekës me nje gamë më të gjerë librash në gjuhën shqipe dhe angleze, revistash shkencore, periodikë, si dhe me shumë literaturë bashkohore për programin e studimit PS në Bsc në “Administrim Biznesi”, duke qenë se edhe literatura bazë duhet të jetë e 5 viteve të fundit por edhe ajo ndihmëse duhet të jetë një literaturë e pasur bashkëkohore.</p> <p><a href="#">Evidenca 4.3.PDF</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Nga RVB si dhe nga vizita në UV, rezulton se institucioni ofron akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët për të shfrytëzuar data bazën e literaturës që është në dispozicion të tyre. Në bibliotekë rezultoi se studentët kanë mundësinë e shfrytëzimit të U library nëpërmjet sistemit të garantuar nga marrëveshja ndërinstytucionale me RASH.</p> <p>Pavarësisht kësaj, nga takimi me studentët rezultoi se ata shfrytëzojnë pak ose aspak bibliotekën e institucionit dhe nuk kishin dijeni për potencialet e saj fizike apo elektronike.</p> <p>Për sa më sipër institucioni GVJ është e mendimit se strukturat respektive të UV, duhet të angazhohet në nxitjen dhe ndërgjegjësimin e studentëve për përdorimin e bibliotekës dhe të data bazës së saj.</p> <p>Nga vizita ne Biblioteke GVJ konstaton se Biblioteka qendrore e UV, është në dispozicion të studentëve në orare të zgjatura nga e hëna në të premte nga ora 8.00-20.00 dhe është në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor ne PS Bsc Administrim Biznesi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka disponon 9 PC dhe disa pajisje të tjera si skaner, fotokopje të cilat sugjerohen që të jenë në shfrytëzim pa kufizime nga studentët. Studentët mund të aksesojnë edhe librarinë elektronike nëpërmjet sistemit të Ulibrary. <a href="#">Evidenca 4.3.PDF</a></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>GVJ nga të dhënat e siguruar nga DVV si dhe gjatë vizitës në institucion konstatoi se nga ana e institucionit për vitin akademik 2016-2017 si dhe 2017-2018 ishin realizuar blerje të literaturës ekonomike. GVJ gjatë vizitës në institucion, nuk siguroi të dhëna për një plan të detajuar për vitin aktual 2019-2020, me të tituj të propozuar nga njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për PS BA në Administrim Biznesi, mbi buxhetin e parashikuar për blerjen e librave, apo për vendimet e marra nga bordi i administrimit për financimin e tyre.</p> <p>Pavarësisht për sa më sipër, në fazën e përcjelljes së komenteve Institucioni, ka paraqitur Evidencën 4 shtesë, në të cilën GVJ konstaton se Departamenti Biznesit ka përcjellë kërkesat buxhetore, mes të cilave zë më vete konstatohet pasurimi i Bibliotekës dhe titujt e sugjeruar nga departamenti. <a href="#">Evidenca 4.3.PDF</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<p><b>X</b></p>		

<p><b>Standardi IV.5</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe</p>	<p>Referuar RVB, Vizitës në institucion si dhe Evidencave të DVV, GVJ konstaton se UV disponon një sistem të menaxhimit të informacionit UVMS që siguron akses për këta përdorues: studentët, stafin akademik, sekretaritet si dhe zyrën e IT. Përveç sistemit elektronik të mësipërm, për studentët informacioni mbahet edhe në formë shkresore, nëpërmjet rregjistrimit themeltar, rregjistrimit të përparimit akademik të studentëve, si dhe rregjistrimit të lëshimit të diplomave, rregjistra këto të cilat u konstatuan nga ana e GVJ gjatë vizitës në institucion dhe që rezultuan me informacione e plotë të kërkuar</p> <p>Nga takimet me stafin akademik, studentët si dhe sekretarinë, përveç formës shkresore të ruajtjes së informacionit si më sipër, UVMS rezultoi të jetë aktiv prej 2017 dhe të ofrojë në mënyrë efektive dhe koherente informacion për studentët dhe vlerësimet e tyre, procesverbalet e lëndëve të ndryshme, mundësi komunikimi interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik, lehtësi në menaxhimin e informacionit për sekretaritet etj..</p> <p>Përdoruesit e sistemit rezultojnë të kenë akses të dedikuar në sistem nëpërmjet kredencialeve të tyre personale, nga vizita në institucion rezultoi se stafi akademik inform studentët për rezultatet nëpërmjet sistemit, studentët informohen në kohë reale për to, kanë të drejtën të paraqesin kërkesat për rishikim nëpërmjet sistemit e të informohen edhe për vlerësimin e tyre final</p> <p>Sistemi elektronik i informacionit të menaxhimit, rezultoi një sistem i</p>



studentëve. <b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	integruar me platforma dhe module që suportojne komunikimin interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik. GVJ sugjeron që ky sistem të përdoret edhe si mundësi për mësimin on-line, si mundësi për ofrimin e leksioneve, PPT, ratseve studimore, videove në shërbim të të studentëve.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni ka një faqe internet me informacion të përmbledhur për të gjitha njësitë kryesore. ( <a href="https://univlora.edu.al">https://univlora.edu.al</a> ) Referuar ëebit të UV, ai ofron informacion për personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në gjuhën shqipe aktualisht, Përsa I përket informacionit në gjuhën angleze, aktualisht ëebi nuk e ofron Rekomandohet që faqja e internetit të jetë më e decentralizuar duke krijuar mundësi edhe per kalimin në faqe interaktive të cdo njësie kryesore, duke ofruar një organizim më efektiv të informacionit për kategori specifike përdoruesish të interesuar për Fakultetin e Ekonomisë dhe programet e studimit që ky fakultet ofron			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se në zbatim të legjislacionit në fuqi, UV harton një raport vjetor. Pjesë e këtij raporti rezultojn të jetë edhe raportimi financiar i cili kalon për miratim në senat dhe më pas në bordin e Administrimit. Ky raport rezultojn të jetë i publikuar në ëebin e UV GVJ konstaton se kostot raportohen si kosto mesatare/student në nivel institucioni. GVJ sugjeron që institucioni të bëjë analizë të kostove në nivel program studimi sic kriteri 1 e kërkon  GVJ nuk konstatoi plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e PS BA AB për një cikël të plotë studimi.  ( <a href="https://univlora.edu.al/raporti-financiar">https://univlora.edu.al/raporti-financiar</a> ).
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezultojn se kërkesat buxhetore propozohen nga njësia bazë dhe ajo kryesore, organizohen në nivel institucioni dhe miratohen nga senati si dhe nga bordi i Administrimit. Të dhënat në të jepen për shpenzimet e planifikuara për financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura etj.  Për sa më sipër GVJ konstatoi se këto informacione jepen në nivel



<p>huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>institucioni dhe jo në nivel program studimi. GVJ rekomandon që në të ardhmen institucioni vlerësojë mundësitë e paraqitjes së këtyre planeve të financimit në nivel njësie bazë dhe program studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>UV si institucion publik i arsimit të lartë, auditohet financiarisht në disa forma. Institucioni i nënshtrohet auditimit të brendshëm, i cili monitoron ecurinë e procesve shpenzuese/investuese dhe lejon të kryhen rregullimet e duhura për efektivitetin e këtyre proceseve. Përveç auditimit të brendshëm, UV auditohet nga Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë si dhe nga KLSH. Për rekomandimet e dy institucioneve të fundit institucioni ka detyrimin e hartimit të një plani masash për përmbushjen e tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ konstaton në DVV, se institucioni ka depozituar raportet vjetore të viteve 2017-2018 dhe të 2018-2019.</p> <p>Në kushtet kur është rritur autonomia financiare, kur numri i studentëve në këtë program studimi ka ardhur duke rënë së bashku me të ardhurat nga tarifat e studentëve, kur kërkesat për cilësi janë rritur dhe konkurrenca po ashtu, lind nevoja për diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij në vitet në vazhdim</p> <p>GVJ mbasi u njoh me komentet e institucionit, mbas përcjelljes së draft RVJ, si dhe me informacionin shtesë të sjellë në këtë fazë, vlerëson pozitivisht, incentivat e para që paraqet institucioni, për parashikimin në rregulloren financiare të mënyrës së shpërndarjes së të ardhurave sipas njësive kontributore, por edhe të ngritjes në të ardhmen të inkubatorit të biznesit në kuadër të projektit IPA Cross Border Grece dhe gjenerimit e të ardhurave shtesë nga shërbimet që mund të ofrojë për të tretët, duke i shërbyer diversifikimit eventual të financimit të programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Referuar raportit vjetor si dhe RVB, rezulton se UV si institucion publik, siguron të ardhurat nga granti për mëimdhënie si dhe nga të ardhurat nga tarifat e studentëve.</p> <p>Në kushtet e zvogëlimit të numrit të studentëve si rezultat i rritjes së mesatares por edhe faktorëve të tjerë, GVJ është e mendimit se UV duhet të sigurojë forma alternative të gjenerimit të fondeve në të ardhmen nga projektet e financuara nga AKSHI, projekte të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare etj.</p>			
	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se UV ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë 3 vjeçar nga hyrja deri në diplomim të studentëve në PS Bsc AB. Këto procedura janë të sanksionuar respektivisht në nenin 39 të rregullores së UV dhe në kreun IV të rregullores së departamentit të Biznesit.</p> <p>Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis nga momenti i informimit për programet akademike për maturanët gjatë muajit mars të cdo viti dhe deri pas përfundimit të studimeve nga ana e tyre.</p> <p><i>(54 Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf, Evidenca 2.5.PDF DVV)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ referuar evidencave si dhe informacionit gjatë takimit me studentët e PS në Bsc AB është e mendimit se aktet rregullatore ku sanksionohen politikat dhe procedurat që ndiqen nga hyrja në dalje e studentëve në PS në UV, ofrojnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë të studentëve mbështetur mbi meritokracinë. Refruar këtu politikave të pranimit, atyre të frekuencimit, të ankimimit si dhe të vlerësimit të arritjeve akademike të studentëve</p> <p><i>(54 Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf, Evidenca 2.5.PDF Evidenca 2.8 DVV)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve janë të publikuara në ëebin zyrtar të UV dhe mund të aksesohen nga të gjithë të interesuarit.</p> <p>Gjithashtu rregullorja për vlerësimin, transferimin etj, gjenden në uebin e UV dhe mund të aksesohen në cdo kohë.</p> <p><i>(<a href="https://univlor.edu.al/2017/10/10/kriteret-e-pranimit-per-tu-rregjistruar-ne-programet-e-ciklit-te-parë-te-studimeve-per-vitin-akademik-2017-2018-brenda-dates-20-10-2017/">https://univlor.edu.al/2017/10/10/kriteret-e-pranimit-per-tu-rregjistruar-ne-programet-e-ciklit-te-parë-te-studimeve-per-vitin-akademik-2017-2018-brenda-dates-20-10-2017/</a>) (<a href="https://univlor.edu.al/rregullorja/">https://univlor.edu.al/rregullorja/</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Referuar takimeve me drejtues të njësive kryesore dhe asaj bazë si dhe informacionit në DVV, rezulton se departamenti dhe fakulteti hartojnë përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>GVJ konstatoi se këto kriteret publikohen</p> <p><i>(Evidenca 2.5.PDF; Evidenca 2.6; Evidenca 5.2.pdf DVV (<a href="https://univlor.edu.al/2017/10/10/kriteret-e-pranimit-per-tu-rregjistruar-ne-programet-e-ciklit-te-pare-te-studimeve-per-vitin-akademik-2017-2018-brenda-dates-20-10-2017/">https://univlor.edu.al/2017/10/10/kriteret-e-pranimit-per-tu-rregjistruar-ne-programet-e-ciklit-te-pare-te-studimeve-per-vitin-akademik-2017-2018-brenda-dates-20-10-2017/</a>))</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si</p>	<p>Referuar takimit me drejtues të njësive kryesore dhe asaj bazë, ata propozojnë kriteret dhe kuotat për PS Bsc AB, të cilat miratohen nga senati dhe i përcillen Ministrisë së Arsimit Rinisë dhe Sporteve. Përcaktimi i tyre për vitin 2019-2020, mbështetet në VKM 295.</p>

dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	10.05.2019, Udhëzimit të MARS 10, 15.05.2019 dhe Udhëzimit 17 të MARS të 30.07.2019.			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se UV dhe strukturat e tij, organizojnë ditët informuese në shkollat e mesme të qytetit për të informuar publikun por dhe për të promovuar ofertën akademike të programeve të studimit. Gjithashtu një formë tjetër rezultoi edhe zhvillimi i open days në mjediset e UV me qëllime informimin e maturanëve të interesuar dhe shpërndarja e broshurave informuese. <i>(Evidenca 5.4; 5.5;5.6)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga vizita në institucion si dhe nga DVV, GVJ konstaton se UV ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e UV, rregulloren e Departamentit të Biznesit. GVJ vlerëson se ky informimin behet ne forma alternative, fizikisht nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet sistemit UVMS, nëpërmjet ëebit të fakultetit. <i>(54 Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf, Evidenca 2.5.PDF Evidenca 2.8 DVV)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. <b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ Referuar takimit me drejtues të njësisë kryesore, rezulton se studentët në UV kanë të drejtën të transferojnë studimet e tyre në degë të ngjashme edhe brenda UV, transferim qe realizohen vetëm në fillim të vitit. Departamenti luan një rol të rëndësishëm në këtë informim të studentëve, por ky informacion sigurohet edhe nëpërmjet uebit të UV  Nga takimi me studentët dhe stafin akademik të programit, rezulton se në fillim të cdo semestri, pedagogët e lëndëve informojnë studentët për programin e lëndës, procedurat e kontrollit të djes dhe skemën e vlerësimit ë dijeve si dhe detyrimet lëndore për studentët. <i>(Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se UV, sanksionon në rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e programit, kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës të cilat janë të publikuara në web. Studentët përvec uebit informohen edhe nga sekretaria mësimore, në lidhje me mundësinë e zhvillimit të temës së diplomës apo provimin e diplomës e kondicionuar kjo nga nota mesatare e studentit në dy vitet e para. <i>(Evidenca 1.4.PDF, Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti	GVJ konstaton nga konsultimi I informacionit në sistemin e ASCAL, si

akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	dhe nga vizitat në institucion, se UV planifikon dhe organizon aktivitete dhe takime informuese dhe “open days” informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, kryesisht maturantëve nga shkollat e mesme të qytetit si dhe të qyteteve të tjera në jug të Shqipërisë <i>(Evidenca 5.5; Evidenca 5.6)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimet me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit, sekretarinë dhe studentët së Departamenti i Biznesit, koordinatori i studentëve si dhe sekretaria mësimore informojnë studentët në lidhje me strukturën e organizimit të programit.</p> <p>Studentët informohen nga strukturat e mësipërme për strukturën e vitit akademik, për kalendarin e provimeve, për orarin mësimor.</p> <p>Këto informacione kanë potencialin të ofrohen edhe nga ëebi i UV, por aktualisht ato rezultojnë të paupdatuara prej dy vitesh.</p> <p>GVJ konstatoi se cdo pedagog gjatë javës së parë të cdo viti informon studentët për lëndën, syllabusin, temat literaturën dhe detyrimet akademike të cdo lënde.</p> <p>Gjithashtu, sikundër zhvillohen open days për studentët e rinj, GVJ sugjeron që institucioni, përvet informimit individual që cdo pedagog bën, të organizojë javën e parë të cdo viti/semestri takime informuese për lëndët, modulet, orarin, provimet, orët e konsultimeve etj.</p> <p>GVJ sugjeron që uebi i UV të vendos në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, sepse referuar gjendjes aktuale të uebit ky informacion nuk ekziston ose është i pjesshëm/i paazhurnuar. Gjithsesi nga komunikimi në institucion, ëebi zyrtar aktualisht është në proces ristrukturimi.</p> <p>GVJ rekomandon që informacioni në lidhje me modulet, lëndët, përmbajtjen dhe kreditet duhet të bëhet i aksesueshëm edhe në faqen ueb për të informuar edhe studentët jashtë institucionit</p> <p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij</p> <p>Nga vizita në zyrën e këshillimit të studentëve dhe asaj të karrierës rezulton se këto zyra zhvillojnë aktivitete për orientimin në tregun e punës, por këto aktivitete deri tani rezultojnë të pakta dhe sporadike. GVJ</p>

	rekomandon që aktiviteti i këtyre zyrave të jetë më i organizuar, më proaktiv, me frekuent, mbështetur në aktivitete të përshtatura me nevojat e studentëve sipas programeve të studimit, për të rritur mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës të studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga takimet me drejtues të njësisë bazë dhe me sekretarine, konstaton se UV harton dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në PS BA AB. Këto të dhëna mbahen manualisht nga sekretaria si dhe në mënyrë elektronike në sistemin e informacionit UVMS sipas procedurave që parashikohen në statutin e UV neni 58 dhe 69 si dhe në rregulloren e UV. Referuar regjistrave themeltar rezultojnë se:</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2016-2017 91 studentë</li> <li>- 2017-2018 58 studentë,</li> <li>- 2018-2019 62 studentë.</li> <li>- 2019-2020 44 studentë</li> </ul> <p>Numri i studentëve të transferuar, për vitin akademik rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2016-2017 4 studentë</li> <li>- 2017-2018 4 studentë</li> <li>- 2018-2019 1 student</li> <li>- 2019-2020 2 studentë</li> </ul> <p>Numri i studentëve të diplomuar, për vitin akademik rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2016-2017 67 studentë</li> <li>- 2017-2018 84 studentë</li> <li>- 2018-2019 60 studentë</li> </ul> <p>Vihet re një ulje e vazhdueshme e numrit të studentëve të regjistruar në programin e studimit BA në AB. Institucioni ia atribuon rënien e numrit të regjistrimeve, vendosjes së mesatares për regjistrim në fakultet të maturanëve, si dhe faktorëve demografikë dhe argumenton se e ka objektiv stabilitetin e numrit të studentëve. GVJ vlerëson pozitivisht përpjekjet e institucionit, për të promovuar në mënyrë të vazhdueshme programin e studimit jo vetëm në qytetin e Vlorës, por edhe në qytete të tjera të jugut.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi (mesataren në hyrje), deri në</p>

	<p>diplomimin e tyre dhe rezulton se i analizon ato në analizat vjetore</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi rregjistrat themelor ku çdo student është rregjistruar dhe ishte pajisur me numer matrikullimi.</p> <p>Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të rregjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e shkollës së mesme, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit etj.</p> <p><i>(Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf) (Evidenca I- Raporti vjetor i UV per vitin 2017-2018.pdf; Evidenca J- Raporti vjetor i UV per vitin 2018-2019.pdf)</i></p>
--	---

<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ referuar të dhënave dhe rregjistrave që institucioni mban konstaton se UV mban të dhëna të vazhdueshme për ecurinë e studentëve deri në diplomim, vlerësimet e tyre në cdo lëndë, rregjistrime këto që përveç procesverbaleve analitike të cdo lënde në hard copy dhe në soft copy, hidhen edhe në rregjistrat themeltar si dhe në sistemin elektronik të UVMS. Këto forma të kombinuara të mbajtjes së të dhënave GVJ i vlerëson pozitivisht sepse rrisin sigurinë e ruajtjes së të dhënave por edhe shpejtësinë e sigurimit të informacionit nga përdoruesit e autorizuar të sistemit.</p> <p>GVJ iu vu në dispozicion nga institucioni të dhëna për cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të cilat rezultojnë se janë pjesë e analizave periodike që departamenti i Biznesit bën apo raporteve vjetore në nivel institucioni. GVJ nuk siguroi as nga RVB dhe as gjatë vizitës në institucion të dhëna për punësimin e studentëve. Rrjeti Alumni rezultoi se ishte krijuar në vitin e fundit në nivel institucioni dhe ende ishte duke u azhornuar me të dhëna.</p> <p>GVJ rekomandon se njësi bazë në rakordim me strukturat e tjera duhet të sigurojnë të dhëna për punësimin e studentëve të diplomuar, gjithashtu strukturat e UV, duhet të jenë më proaktive në krijimin e lidhjeve më efektive me sipërmarrësit, institucionet publike dhe vendimmarrësit lokal për rritjen e punësimit të studentëve të diplomuar në PS në AB.</p> <p>Këto aktivitete duhet të jenë më frekvente dhe të promovojnë punësimin e studentëve por edhe arrijtjet në punësimin e studentëve duke siguruar një lidhje më të mirë mes aktorëve në tregun e punës, e cila do të shërbente edhe si njëri prej faktorëve të frenimi të rënies së numrit të rregjistruarve në vitet e ardhshme. <i>(Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf) (Evidenca 1.9.PDF, Evidenca I- Raporti vjetor i UV per vitin 2017-2018.pdf; Evidenca J- Raporti vjetor i UV per vitin 2018-2019.pdf)</i></p>
--	---

<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>E drejta për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është e sanksionuar në LAL 80/2015, neni 98, 99 dhe në Statutin e UV, neni 74. GVJ konstatoi nga RVB dhe nga informacioni në faqen zyrtare të UV se janë zhvilluar zgjedhjet për këshillat studentorë të cilët tashmë kanë krijuar strukturat e tyre të dala nga zgjedhjet.</p> <p>Gjithashtu rezulton, studentët e UV janë të përfaqësuar në senat nga dy studentë dhe kanë edhe një përfaqësues të tyre në bordin e administrimit mbas riorganizimit të Bordeve të Administrimit. Përfaqësimi i tyre në këto nivele vendimmarrëse, krijojnë mundësinë e përfaqësimit të kërkesave të tyre në vendimmarrjen e UV.</p> <p>Referuar RVB, tabela 24, studentët kanë marrë pjesë aktive në procesin e shpërndarjes dhe të administrimit të pyetësorëve të studentëve.</p> <p>Gjithashtu studentët e programit rezultojnë të jenë të përfshirë edhe në grupin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, por përfshirja e tyre këtu duhet të jetë më aktive sidomos në fushën dedikuar studentëve</p> <p>GVJ rekomandon që institucioni të garantojë një përfshirje më të lartë dhe më aktive të studentëve në aktvitetet e ndryshme vendimmarrëse dhe këshilluese, me qëllim plotësimin e interesave të tyre. Angazhimi i studentëve duhet të jetë më konkret, më i verifikueshëm dhe i matshëm.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstaton se organizimi i PS BA në AB, është mbështetur në bazën ligjore respektive për përcaktimin e ngarkesën.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se institucioni synon që procedurat e transferimit, të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore ( Rregulloren dhe Statutin e UV) nga njëra anë, dhe nga ana tjetër të shmangin procedurat burokratike për ekuivalentimin e lëndëve për studentët që transferohen nga degë të përafërta të UV dhe nga universitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Rezultoi nga vizita në institucion se këto procedura joburokratike përfshijnë edhe ekuivalentimin e lëndëve të studentëve që kanë kryer mobilitetë në kuadër të programit Erasmus+, ku ekuivalentimi behet mbi bazë të marrëveshjes së mobilitetit. Kjo praktikë rezulton se ndiqet në institucion dhe është një praktikë e mirë që mund të përdoret edhe për studentët e PS Ba në AB, të cilët deri tani nuk kanë kryer mobilitete të tilla. <i>(Evidenca 2.8)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga takimi me drejtues të njësisë bazë, rezultoi se përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të PS në BA AB, është indirekte nëpërmjet feedbackut që njësi bazë merr prej pyetësorit të studentëve që zhvillohen dy herë në vit nga NJSBC</p> <p>GVJ vlerëson përfshirjen e studentëve në anketat e zhvilluar për vlerësimin e procesit mësimor.</p> <p>Nga ana tjetër, në komentet që institucioni paraqiti në fazën e draft RVJ, argumenton se institucioni në mënyrë të vazhdueshme garanton përputhshmërinë e programit mësimor në bch. në AB, me ndryshimet në bazën ligjore si dhe me studimet e tregut të realizuara në vitet 2017 dhe 2019. Institucioni argumenton se në këtë studim tregu, përveç punëdhënësve, kanë përfshirë edhe studentët, duke marrë feed back prej tyre për programet e</p>

	studimit. ( <i>Evidenca 6.6.PDF; Evidenca 6.7.pdf</i> )			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre</p> <p>Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët, mbas hedhjes së notave në sistemin UVMS, studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezulttit, konsultimit me tezën e provimit e më pas pedagogu I lendës vendos notën përfundmtare. Nëse studenti serish e ankimon këtë rezultat, është dekani I cili ngre një komision të ri për rishikimin e rezulttit.</p> <p>Gjithashtu nëpërmjet anketimeve semsterale studentët kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.</p> <p>GVJ konstaton se provimet bëhenë pasekretuara. GVJ sugjeron që institucioni të vlerësojë mundësinë e rishikimit të kësaj praktike, e cila është rrallë herë e ndeshur. Pavarësisht kohës fizike dhe ngarkesës fizike që do të kërkonte procesi I sekretimit dhe csekretimet, refruar praktikave të shumta të konsutura, rezulton se procesi i sekretimit rrit paanshmërinë në vlerësimin dhe ul mundësinë e paragjykimit të procesit të vlerësimit nga studentët</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UV nëpërmjet njësisive të posaçme në strukturën organizative zhvillon procedura në shërbim të informimit të studentëve mbështetur në statutin edhe rregulloren e UV. Përsa më sipër është Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumnit dhe Aktiviteve kulturore, që në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe atë bazë informojnë studentët në mënyrë të vazhdueshme</p> <p>UV ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, që kanë përbërje të tyre, struktura në nivel institucioni sic është, Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në nivel njësie bazë sic janë sekretaria e Departamentit të Biznesit dhe Koordinatori për marrëdhëniet me studentët. (<i>Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf, neni 77, Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf neni 85</i>) (<i>Evidenca 1.7. Evidenca 2.4</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit</p>	<p>Referuar Statutit dhe Rregullores së institucionit janë të sanksionuara detyrat që Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumnit dhe Aktiviteve kulturore duhet të kryejne.</p> <p>GVJ konstatoi aktivitete informimi me maturanet të kryer nga kjo zyrë mbi bazën e një kalendari paraprak, aktivitete informimi për studentët e vitit të parë, gjithashtu të aktiviteteve trajnuese/informuese sic është</p>



<p>mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>shkrimi i një CV.</p> <p>Pavarësisht për sa më sipër, GVJ është e mendimit se Sektori i Keshillimit të Karrierës Alumnit dhe Aktiviteteve kulturore, duhet të planifikojë dhe të organizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe më të shpeshtë, aktivitete informuese dhe orientuese për studentët, në lidhje me praktikën profesionale dhe punësimin e tyre të ardhshëm. Rekomandohet një kombinim më i përshtatshëm midis aktivitetit të zyrave administrative dhe sistemit të keshillimit në bazë të secilit departament. Kjo do të mundësojë ngritjen e një sistemi të më përshtatshëm të informimit, keshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët në lidhje me praktikën profesionale apo me punësimin e ardhshëm, apo për ndarjen e eksperiencave të studentëve në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+ etj.</p> <p>GVJ konstatoi se UV ka krijuar prej një viti Rrjetin Alumni, I cili është në azhurnim e sipër. Referuar Evidenceës për rrjetin Alumni, vihet re se numri i ish-studentëve të PS Administrim Biznesi, në Alumni të UV është ende i vogël.</p> <p>GVJ sugjeron që zyra përgjegjëse të intensifikojë përpjekjet dhe të diversifikojë mekanizmat për plotësimin e rrjetit Alumni të Administrim Biznesi si dhe të përpunojë dhe analizojë të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit (<i>Evidenca 5.6; Evidenca 5.7; Evidenca 6.8.pdf</i>)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p><b>Standardi VI.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e</p>	<p>GVJ referuar DVV si dhe takimeve në institucion konstaton se UV ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional, përgjegjësitë e të cilës janë sanksionuar në statutin dhe rregulloren e UV.</p> <p>Struktura e NSBCI në UV është një strukturë relativisht e re e cila në me vendim Senati në 14.02.2018 është riorganizuar. GVJ nuk siguroi të</p>

<p>Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>dhëna të mëhershme për aktivitetin e NJSBC</p> <p>Stafi aktual i njësisë përbëhet nga 4 anëtarë staf administrativ me një kohëzgjatje në detyrë prej dy vitesh deri tani.</p> <p>NJSBCVI funksion në bazë të strategjie institucionale e cila konsiston në procedurat për vlerësimin e pyetësorëve të studentëve</p> <p>Këto procedura parashikojnë plotësimin e një pyetësori të miratuar nga senati, dy herë në vit, para fillimit të sezonit të provimeve dhe nxjerrjen e rezultateve pas daljes së rezultateve të studentëve.</p> <p>Aplikimi bëhet on-line dhe përfshirja e studentëve është e detyrueshme, mos plotësimi I anketës e penalizon studentin dhe ai nuk mund te informohet për rezultatet e testimeve të lëndevë.</p> <p>NJSBCVI i përpunon pyetësorët dhe rezultatet i përcillen rektorit I cili ia përcjell njësive kryesore e më tej njësive bazë. Mbas analizës së të dhënave të pyetësorëve, njësitë bazë dhe ato kryesore propozojnë masat për përmirësimin e problematikave të identifikuara, të cilat formalizohen më tej në nivel institucioni. Raporti final bashkë me planin e masave miratohet nga senati.</p> <p>GVJ konstaton se në manaxhimin e pyetësorëve të studentëve marrin pjesë studentë të fakulteteve të ndryshme</p> <p><i>(Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf, nenet 81, 82,83), (Evidenca 1.7), (Tabela 24, RVB), (Evidenca 6.1;Evidenca 3.1.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Referuar Evidencës 6.6, ku jepet formati I pyetësorit, vihet re se pyetësori është i përbërë nga 17 pyetje të cilat bëjnë një vlerësim të përgjithshëm të programit tëstudimit që siguron informacion të rëndësishëm duke qenë se edhe plotësimi nga studentët është I detyrueshem.</p> <p>Po kështu nga konsultimi i pyetësorit për matjen e performancës së pedagogut konstatojmë që mënyra se si ky pyetësor është hartuar vështirëson matjen e performancës. Fushat që do të vlerësohen dhe indikatorët përkatës nuk janë të qarta për të arritur në rezultate të përdorshme në lidhje me performancën e stafit akademik ose jo akademik.</p> <p>GVJ rekomandon përdorimin e mekanizmave të tjerë alternativë si fokus grupe me studentë, vlerësim të stafit nga drejtuesi i njësisë kryesore, vetëvlerësim të stafit, vlerësim të stafit akademik për kapacitet institucionale etj.</p> <p>Mekanizmat e mësipërm do të realizonin një vlerësim 360 grade, për të identifikuar qartësisht dhe saktësisht problematikat dhe për të adresuar në mënyrë korrekte zgjidhjet</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të licencimit, të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë, në këtë kuadër UV është akredituar për një priudhë tre vjecare dhe ka hartuar edhe p lanet e masave që duhet të zbatohet për rekomandimet e lëna nga bordi I Akreditimit.</p>

	(Evidencës 6.6)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**Standardi VI.2**  
**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	GVJ referuar strukturës organizative dhe takimeve në institucion, konstaton se ne UV Sektori i Kurrikulave është njësi e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Sektori I Kurrikulës, orienton, vlerëson dhe monitorn nëse hartimi i PS është në përputhje me bazën ligjore respektive dhe nëse procedurat për miratimin e tyre janë të duhurat.  (Evidenca 6.5.PDF)			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	UV përdor metodologji vlerësimi mbështetur kryesisht tek instrumenti i pyetësorit prej të cilit synon të sigurohet një feedback për ecurinë e PS. Pyetësorë të tillë janë aplikaur për dy vite 2017-2018 si dhe 2018-2019, duke qenë se NJSBCVI është një strukturë relativisht e re  GVJ rekomandon diversifikimin e mekanizmave dhe instrumentave vlerësuese, si fokus grupe me studentët, vlerësim të stafit për ecurinë e programit dhe kapaciteteve institucionale për mbarëvajtjen e PS etj.  (Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2018-2019.pdf)			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.  <b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	GVJ konstaton se rezultatet e pyetësorëve të studentëve dokumentohen dhe i përcillen drejtuesve të njësisë kryesore dhe asaj bazë, për shqyrtim të problematikave, identifikim të praktikave të mira dhe propozimin e masave të për përmirësimin e cilësisë dhe adresimin e problemeve. Njësi bazë dhe ajo kryesore analizojnë gjetjet e pyetësorëve dhe hartojnë një plan masash të nevojshëm për përmirësimin e situatës  GVJ nuk hasi në një raport të vlerësues për zbatimin e masave të lëna as per vitin 2017-2018 dhe as për vitin 2018-2019. GVJ rekomandon që institucioni të ndjek zbatimin e masave të propozuara nga njësitë kryesore dhe të miratuara nga senati për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. (Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2018-2019.pdf; Evidenca 6.4.pdf)			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

standardit			X	
------------	--	--	---	--

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i PS BA në AB, rezulton të bëhet për herë të parë, në kuadër të këtij akreditimi programor.</p> <p>Vlerësime të pjesëshme, janë bërë dy vitet e fundit akademike nëpërmjet pyetësorëve të organizuar nga NJSBCVI</p> <p>GVJ rekomandon që në akreditim e ardhshëm institucional të përfshihen edhe informacionet e vlerësimit programor sic është edhe vlerësimi programor I PS BA ne AB</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për vlerësimet semestrale sikundër është trajtuar edhe në standardet më herët, UV përdor si instrument pyetësorin.</p> <p>GVJ mbështet idenë e përdorimit të mekanizmave të ndryshëm të vlerësimit, mbështetur në praktikat më të mira në këtë lëmi, të instucioneve të tjera vendase apo të huaja.</p> <p>Referuar RVB, UV përdor metoda të drejtëpërdrejta vlerësimi, por GVJ nuk identifikoi ne DVV dhe gjatë vizitës në institucion, metoda të drejteperdrejta që janë në përmbajtje të kriterit 3.</p> <p>Gjatë fazës së paraqitjes së komenteve nga ana e institucionit, paraqiten disa mekanizma të tillë nëpërmjet Evidencës 6, si vlerësimi i performancës së stafit në disa drejtime si për syllabusin, literaturën, për pjesëmarrjen në kërkimin shkencor dhe projekte, për procesin mësimor etj. GVJ inkurajon që institucioni t'i referojë këto mekanizma në vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit në përmbushje të këtyre kriterëve dhe t'i dokumentojë ato.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky</p>	<p>UV përdor si instrument kryesor pyetësorin, dy herë në vit në përfundim të cdo semestri, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Në lidhje me praktikat e tjera dhe instrumentat e tjerë të tërthortë në kriterin 4, UV nuk ka vënë në dispozicion procedura të anketimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik si edhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet grumbullimit të informacionit nga ish studentët, bashkëpunëtorët e programit të studimit etj.</p> <p>GVJ gjykon që institucioni duhet t'i përfshijë në të ardhmen edhe këto instrumente dhe të krijojë nje bazë te gjerë e periodike informacioni si edhe mënyra të krahasueshme të përpunimit të</p>

program.	informacionit me qëllim krahasueshmërinë e tij nga një vit në tjetrin, nga informacioni i marrë nga stakeholdersit e mësipërm.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ konstaton se UV ka NJSBVI një njësi qëndrore në nivel institucioni me një staf administrativ prej 4 anëtarësh, drejtor drejtorie, përgjegjës si dhe 2 specialistë të cilët kanë të sanksionuar në statut detyrimin për performimin e procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Procedura e analizës së pyetësorëve është dhe ndarja e detyrave që rezultojnë e përcaktuar me vendimin 21 të Senatit Akademik të 21.05.2018. Rezultojnë të përfshirë në këtë proces, NJSBVI, Senati, Rektorati dhe Dekanati.</p> <p>GVJ nuk gjeti evidence në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë për përfshirjen e stakeholdersve të jashtëm me fokus përmirësimin e cilësisë së PS BA AB si p.sh të Përfaqësuesve të Biznesit, të shoqatave të biznesit, të institucioneve publike, vendimmarrës lokal etj.</p> <p>Pyetësorët zhvillohen on-line, kështu ruhet anonimiteti i përgjigjeve të studentëve. Diskutimet zhvillohen mbi problematika duke shmangur diskriminimi apo pabarazinë kundrejt stafit akademik dhe studentëve</p> <p>Pavarësisht se NJSBVI ka detyrimin institucional për ndjekjen e procedurave për sigurimin e Brendshëm të cilësisë, duke iu referuar raportit të analizës së gjetjeve për 2018-2019, konstatohen se gjetjet dhe analizat janë të përgjithshme, nuk janë të detajuara për një pyetësor me 16 pyetje që aplikohet, e gjithashtu ato nuk analizohen në nivel program studimi. Në këtë kuadër GVJ, sugjeron një përfshirje më të madhe të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë në manaxhimin e proceseve për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe në specifikimin e tyre në nivel programor, ndërkohë që NJSBVI ndjek procesin në nivel institucional</p> <p>Për këtë rekomandohet që anëtarë të njësisë bazë, përfaqësues të studentëve të programit, dhe përfaqësues të stakeholdersve të jashtëm të jenë pjesë e një grupi adhoc për sigurimin e cilësisë në nivel njësie bazë dhe në nivel programor.</p> <p>Referuar evidences 21, të fazës së komenteve, UV ka organizuar në trajtën e një tavoline të rrumbullakët pjesëmarrësit, një workshop kryesisht me Institucionene Publike si Zyra e Punës, Drejtoria e</p>

	<p>Tatimeve, Prefektura, Zyra Arsimore, Dhoma e Tregtisë, Përfaqësues i Shoqatës së Operatorëve Turistik në Vlorë, drejtues të Bankave ë Nivelit të Dytë në Qytetin e Vlorës etj, dolën me një paketë rekomandimesh ku dy prej tyre i drejtoheshin në mënyrë specifike Programeve që ofronte Fakulteti i Ekonomisë, duke përfshirë edhe programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi. Për sa më sipër GVJ sugjeron që këto rekomandime të vlerësohen nga institucioni dhe të përfshihen në procesin e përmirësimit të programeve të studimit.</p> <p><a href="#">Evidenca 6.1.pdf</a>; <a href="#">Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf (neni 81,82, 83)</a>; <a href="#">Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf( neni 86)</a></p> <p>(<a href="#">Evidenca 6.4.pdf</a> Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2018-2019.pdf)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ referuar DVV dhe uebit zyrtar të UV, konstaton se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Vendimet e senatit si dhe raporti i analizes së pyetësorëve të studentëve rezultojnë të publikuar në faqen zyrtare.</p> <p>Raporti respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Ky raport rezulton të jetë i fokusuar tek masat për përmirësim të mëtejshëm në nivel institucioni, por jo në nivel programor. GVJ konsultoi dy raporte, të vitit 2017-2018 dhe të vitit 2018-2019. Raportet përmbajnë një plan masash për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe për adresimin e problemeve. Rezulton se njësia bazë përgjegjëse për programin, ka propozuar plan masah për adresimin e problematikave. GVJ sugjeron që në të ardhmen këto të fokusohen në nivel programor dhe të jene më specifike.</p> <p>(<a href="https://univlori.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-%20raportit-te%20analzes-se%20pyetesorit-te%20studenteve">https://univlori.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-%20raportit-te%20analzes-se%20pyetesorit-te%20studenteve</a>)</p> <p>(Evidenca 6.4.pdf; Evidenca K- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2017-2018.pdf; Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2018-2019.pdf)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Sipas RVB, NJSBCVI raporton në mënyrë të vazhdueshme në senat për procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>GVJ nuk hasi në një raport të vlerësues për zbatimin e masave të lëna as për vitin 2017-2018 dhe as për vitin 2018-2019. GVJ rekomandon që institucioni të ndjek zbatimin e masave të propozuara nga njësitë</p>

së programit të studimit.	kryesore dhe të miratuara nga senati për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga takimi me NJSBCVI rezulton se UV nëpërmjet NJSBCVI organizon veprimtari me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznesi” të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Bashkëpunimet me institucione të shumta homologe jashtë vendit;
2. Hartimi i udhëzuesit në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies ku fokusi është në implementimin e modelit “Studenti në Qendër”
3. Prioriteti në Planin Strategjik Institucional 2018-2024, zhvillimi i “Universitetit Smart”, për shfrytëzimin me efektivitet të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit në sistemin e menaxhimit dhe organizimit institucional.
4. Sistemi informacionit efektiv
5. Procedura e transferimit të studentëve fleksibile dhe joburokratike
6. Lokacioni dhe vendodhja e Universitetit në zonë me akses të lartë
7. Kualifikimi i stafit akademik
8. Praktikrat motivuese të financimit të kostove individuale për kërkimin shkencor të stafit akademik
9. Nivel i lartë i përfshirjes së stafit akademik efektiv në Programin e studimit Bsc në Administrim Biznesi
10. Stafi administrativ i angazhuar

**Pika të dobta:**

1. Në pjesën më të madhe të syllabuseve të lëndëve, nuk është e përcaktuar viti i botimit të literaturës bazë të detyrueshme, ose është relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41, konsideron literaturën e 5 viteve të fundit

2. Ojektivat formues dhe kompetencat profesionale janë të përcaktuara në Supplementin e Diplomës, por jo në planet mësimore apo rregulloren e programit.
3. GVJ konstaton se bashkëpunimi me aktorët e biznesit vendas i programit në fjalë është vetëm në kuadër të praktikave profesionale.
4. Kushtet infrastrukturore fizike dhe të teknologjisë në shërbim të mësimdhënies në auditore jo shumë të përshtatshëm
5. Provimet nuk zhvillohen në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim.
6. Për biblioteken:
  - a. Hapësirat e bibliotekës së institucionit janë të vogla dhe të pamjaftueshme duke konsideruar numrin e studentëve që studiojnë në institucion;
  - b. Biblioteka e UV duhet të ketë një gamë më të gjerë librash në gjuhën shqipe dhe angleze, revistash shkencore, periodikë, si dhe me shume literaturë bashkohore për programin e studimit PS në bch në Administrim Biznesi
  - c. Nivel i ulët i përdorimit të studentëve të bibliotekes
7. Faqja e internetit të jetë më interaktive dhe të sigurojë decentralizim në nivel fakulteti
8. Gjenerim të fondeve nga burime alternative sic është pjesëmarrja ne projekte
9. Përfshirje e ulët e studentëve në aktivitete të ndryshme vendimmarrëse dhe këshilluese
10. Mekanizmat e sigurimit te brendshëm të cilësisë të padiversifikuar

### **Rekomandime:**

1. Rekomandohet azhurnimi i literaturës, pasi në një pjesë prej lëndëve është relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41, konsideron literaturën e 5 viteve të fundit
2. Rekomandohet përmirësim i kushteve infrastrukturore, për t` krijuar një ambient më të përshtatshëm fizik si dhe për kushte më bashkëkohore të mësimdhënies/mësimnxënies, si:
  - a. Vendosjen në funksion të sistemit të sistemit termik të ambienteve
  - b. Pajisjen me “ëhiteboard” të auditorëve
  - c. Pajisjen me mjete audiovizive të auditorëve
3. Rekomandohet që përtej analizave sasiore, njësia bazë të fokusohet edhe në analiza cilësore si dhe shkëmbimin e eksperiencave midis stafit apo hulumtimit me fokus përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie.
4. Rekomandohet se përtej udhëzuesit për zhvillimin dhe përdorimin e metodave novatore në mësimdhënie, njësia bazë duhet të iniciojë procese të trajnimeve të ndryshme për implementimin e këtyre metodave së mësimdhënies e mësimnxënies.
5. Rekomandohet që institucioni të inkurajojë personelin akademik efektiv në realizimin e orëve të hapura dhe seminareve mbi zhvillimet të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit dhe jo vetëm nëpërmjet akademikëve të ftuar në leksione.
6. GVJ rekomandon publikimin e thirrjeve për punësim edhe ne burime të tjera alternative sic është faqja e APP, apo media vizive dhe e shkruar duke i shërbyer kështu shpërndarjes së informacionit në shkallë më të gjerë, duke rritur visibilitetin e thirrjes për të rritur numrin e aplikantëve cilësore.
7. Strukturat e UV, duhet të jenë më proaktive në krijimin e lidhjeve më efektive me sipërmarrësit, dhe vendimmarrësit lokal, për rritjen e numrit të bizneseve si dhe inkorporimin e një bashkëpunimi



sinergjik, për të mundësuar si zhvillimin e praktikave sa më efektive si dhe rritjen e punësimit të studentëve të diplomuar në PS në AB. Departamenti të kryejë studime periodike mbi tregun e punës dhe ti reflektojë ato në planet mësimore, duke forcuar bashkëpunimin drejt ko-krijimit të vlerave për industrinë, për programin e studimit dhe studentët e tij.

8. UV duhet të zgjerojë fondin e bibliotekës me një gamë më të gjerë librash në gjuhën shqipe dhe angleze, revistash shkencore, periodikë, si dhe më shumë literaturë bashkohore për programin e studimit PS në bch në Administrim Biznesi dhe duhet të sigurohet një ndërgjegjësim i studentëve për përdorimin e bibliotekës dhe të data bazës së saj.
9. Faqja e internetit të jetë më e decentralizuar duke krijuar mundësi edhe për kalimin në faqe interaktive të cdo njësie kryesore, duke ofruar një organizim më efektiv të informacionit për kategori specifike përdoruesish të interesuar për Fakultetin e Ekonomisë dhe programet e studimit që ky fakultet ofron;
10. UV të garantojë një përfshirje më të lartë dhe më aktive të studentëve në aktivitete të ndryshme vendimmarrëse dhe këshilluese, me qëllim plotësimin e interesave të tyre. Angazhimi i studentëve duhet të jetë më konkret, më i verifikueshëm dhe i matshëm.
11. Rekomandohet një kombinim më i përshtatshëm midis aktivitetit të zyrave administrative dhe sistemit të këshillimit të studentëve, në bazë të secilit departament. Kjo do të mundësojë ngritjen e një sistemi të më përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët në lidhje me praktikën profesionale apo me punësimin e ardhshëm, apo për ndarjen e eksperiencave të studentëve në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+ etj.
12. UV të vlerësojë mundësinë e aplikimit të sekretimit të provimeve, sepse pavarësisht kohës fizike dhe ngarkesës fizike që do të kërkonte procesi i sekretimit dhe c'sekretimit, refruar praktikave të shumta të konsultura, rezulton se ai rrit paanshmërinë në vlerësimin dhe ul mundësinë e paragjyqimit të procesit të vlerësimit nga studentët, Për punimet e diplomës, rekomandon që institucioni të investojë në sigurimin e një programi antiplagjaturë.
13. Rekomandohet përdorimi i mekanizmave alternativë si fokus grupe me studentë, vetëvlerësim të stafit, vlerësim të stafit akademik për kapacitetet institucionale etj. Anëtarë të njësisë bazë, përfaqësues të studentëve të programit, dhe përfaqësues të stakeholders-ve të jashtëm të jenë pjesë e një grupi ad-hoc për sigurimin e cilësisë në nivel njësie bazë dhe në nivel programor

## **Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle, Bachelor in “Business Administration” at the HEI “Ismail Qemali” University, Vlora.**

### **Strengths and affirmations:**

1. Cooperation with numerous counterpart institutions abroad;
2. Designing a guide at the institutional level for the development and use of various innovative teaching methods where the focus is on the implementation of the model "Student in the Center"
3. Priority in the Strategic Institutional Plan 2018-2024, the development of "Smart University", for the effective use of communication and information technology in the management system of institution.
4. Effective information system
5. Flexible and non-bureaucratic student transfer procedure

6. Location of the University, that is in an area with high access
7. Qualification of academic staff
8. Motivational practices of financing individual costs for scientific research of academic staff
9. High level of involvement of effective academic staff in the Bsc Study Program in Business Administration
10. Administrative staff engaged

**Weak points:**

1. In most subject syllabi, the year of publication of the required basic literature is not specified, or it is relatively outdated, while DCM 41 considers the literature of the last 5 years
2. Training objectives and professional competencies are defined in the Diploma Supplement, but not in the curricula or program regulations.
3. EEG finds that the cooperation with local business actors of the program in question is only in the framework of professional practices.
4. Physical and technological infrastructure conditions in the service of teaching in auditoriums not very suitable
5. Exams are not conducted anonymously with secretion or codification.
6. For the library:
  - a. The library space of the institution is small and insufficient considering the number of students studying in the institution;
  - b. The UV Library should have a wider range of books in Albanian and English, scientific journals, periodicals, as well as more contemporary literature for the SP study program in Bch in "Business Administration"
  - c. Low level of use of library from students
7. The website should be more interactive and provide decentralization at the faculty level
8. Generation of funds from alternative sources such as participation in projects
9. Low student involvement in various decision-making and counseling activities
10. Non-diversified internal quality assurance mechanisms

**Recommendations:**

1. It is recommended to update the literature, as in some of the subjects it is relatively outdated, while DCM 41, considers the literature of the last 5 years
2. It is recommended to improve the infrastructural conditions, in order to create a more suitable physical environment as well as for more modern teaching / learning conditions, such as:
  - a. Placement of the thermal system of the premises
  - b. Equipping auditors with "whiteboard"
  - c. Equipping auditors with audiovisual tools

3. It is suggested that beyond quantitative analysis, the core unit should also focus on qualitative analysis as well as the exchange of experiences between staff or research with a focus on further improving the quality of teaching.
4. It is recommended that beyond the guidelines for the development and use of innovative teaching methods, the core unit should initiate various training processes for the implementation of these teaching and learning methods.
5. It is recommended that the institution encourage effective academic staff in conducting open classes and seminars on new developments in science and technology as extra curricular activities, not only through academics invited to lectures.
6. EEG recommends the publication of calls for employment in other alternative sources such as the PPA site, or visual and print media, thus serving the dissemination of information on a larger scale, increasing the visibility of the call to increase the number of quality applicants.
7. UV structures should be more proactive in creating more effective connections with entrepreneurs and local decision makers, to increase the number of businesses and to incorporate a synergistic cooperation, to enable the development of more effective practices and increasing employment of SP graduate students in AB. The Department should conduct periodic studies on the labor market and reflect them in the curriculum, strengthening cooperation towards co-creation of values for the industry, the study program and its students.
8. UV should expand the library fund with a wider range of books in Albanian and English, scientific journals, periodicals, as well as more contemporary literature for the SP study program in Bch in Business Administration and should provide an awareness of students for the use of the library and its database.
9. The website should be more decentralized, creating opportunities for the transition to interactive pages of each main unit, providing a more effective organization of information for specific categories of users interested in the Faculty of Economics and study programs that this faculty offers;
10. UV should guarantee a higher and more active involvement of students in various decision-making and advisory activities, in order to fulfill their interests. Student engagement should be more concrete, more verifiable and measurable.
11. A more appropriate combination between the activity of administrative offices and the student counseling system is recommended, based on each department. This will enable the establishment of a more appropriate system of information, counseling and ongoing assistance for students in relation to professional practices or future employment, or to share the experiences of students in mobility within the Erasmus + program, etc.
12. UV to evaluate the possibility of applying the secretion of exams, because despite the physical time and physical load that would require the process of secretion and non-secretion, refraining from numerous consulting practices, it turns out that it increases impartiality in assessment and reduces the possibility of prejudice of the assessment process by students, For diploma papers, recommends that the institution invest in providing an anti-plagiarism program.
13. It is recommended to use alternative mechanisms such as focus groups with students, staff self-assessment, evaluation of academic staff for institutional capacity, etc. Members of the core unit, student representatives of the program, and representatives of external stakeholders to be part of an ad-hoc group for quality assurance at the basic unit level and at the program level.

## Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	